



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Bachelor
në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Dr. Monika Hasani Hoshafi

2. Prof. As. Dr. Albana Ndoja Deda

Maj 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”, ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhësisë n bashkëpunim me Departamentin e Letërsisë dhe të Gazetarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor "Gjuhë Shqipe dhe Letërsi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 4964/3 datë 12.11.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 266 datë 10/08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 / 7
18	Numri i studentëve:	23 [tre vitet e fundit]
e19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 16 dhe 17 Janar 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të Parë “**Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi**”. Vlerësimi i këtij programi studimi bëhet për herë të parë nga ASCAL-i.

Për të kryer vlerësimin e programit të studimit, GVJ u mbështet në RVB-në, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës, si dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi.

Fillimisht, mund të themi se është bërë një punë e përgjegjshme dhe mjaft serioze për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, për grumbullimin e të dhënave të bollshme në shërbim të vlerësimit për akreditimin e programit. Ky aplikim është përvoja e parë për departamentet që mbulojnë programin e studimit. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe qartësi dhe me përpjekje që të pasqyrohen me vërtetësi, gjendja aktuale e cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ, si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur burime të nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon DGj dhe DLG, si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se ky program studimi mbulohet njëherazi nga dy departamente, Departamenti i Gjuhësisë dhe Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë.

Departamentet pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan kanë në përbërje staf akademik me përvojë dhe të kualifikuar që i përballon shumë mirë kërkesat shkencore që shtrun ky program studimi. GVJ-ja vërejtë se stafi akademik duhet të përfshihet dhe të mbështet insitucionalisht më shumë në projekte e trajnime ndërkombëtare.

Sfidë e departamenteve është ndërkombëtarizimi i tyre nëpërmjet programeve, projekteve e trajnimeve me departamentet simotra në nivel ndërkombëtar.

Sfida më e madhe që duhet të zgjidhin në të ardhmen këto departamente është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi. Aktualisht ka vetëm 8 studentë në vitin e parë, pra të regjistruar për vitin 2021-2022, për vitin 2020-2021 15 studentë dhe për vitin 2019-2020, 14 studentë. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, por të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi në mesuesi në universitetet rajonale. Si rrjedhojë prej UNIEL-it, prej Fakultetit të Shkencave Humane, ku bën pjesë ky departament, duhen hartuar politika më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për të rritur numrin e studentëve.

Megjithëse pas zhvillimit të këtij programi studimi, Bachelor, studenti i ka të pakta mundësitë e punësimit DGj/DLG si dhe strukturat përkatëse të UNIEL-it duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (alumni) dhe të krijojnë databazën e alumnit edhe në nivel departamenti.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhej nga Prof. As. Dr. Monika Hasani Hoshafi, Prof. As. Dr. Albana Ndoja Deda dhe përfaqësuesja e ASCAL, znj. Endra Velaj.

Grupi studioi me shumë kujdes Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Departamentit të Gjuhësisë dhe Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë, në Fakultetin e Shkencave Humane (Tetor 2022) (RVB për programin “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”), për t’u njohur paraprakisht me gjendjen dhe problematikën e programit. Bazuar në këtë informacion u hartua një draft paraprak i raportit të GVJ-së, shoqëruar me një seri pyetjesh që lindën gjatë studimit të tij. Gjatë vizitës dy ditore (16 dhe 17 Janar 2023) pranë dy njësive që mbulojnë programin, pyetjet në fjalë iu adresuan personave përgjegjës. Përgjigjet e marra u bënë pjesë e dokumentit final të këtij raporti. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori kontakte dhe bisedoi me personat e poshtëshënuar;

- Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane
- Përgjegjësin e departamentit të GjS
- Përgjegjësin e departamentit të GjLG
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit
- Stafin akademik të Departamentit të Gjuhësisë
- Stafin akademik të Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë
- Zyrën e Karrierës dhe Alumni
- Përfaqësues të Drejtorisë Juridike
- Përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Karrierës
- Drejtorinë e Kurrikulave
- Takim me Drejtorinë e Kërkimit shkencor
- Studentë të programit të studimit nga tri vitet akademike
- Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll arkivës.
- Sekretarinë mësimore
- Përfaqësues të Bibliotekës

GVJ vizitoi mjediset e mësimit dhe aktivitetit tjetër studentor në IAL (auditorë, laboratorë, biblioteka).

Ky raport pasqyron përmbledhtazi mendimet tona për programin. Ndonëse në tërësinë e vet raporti ynë konfirmon gjetjet kryesore të RVB-së, ndan edhe qëndrime të ndryshme prej tij lidhur me aspekte të caktuara të gjendjes dhe shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë së programit.



Më datë 07.04.2023 përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. prot.2/48 dërogeth në institucion Raporti i Vlerësimit të Jashtëm , IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 13.04.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. Protokolli 642/23, datë 13.04.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e insitucionit mbi draf-raportin sqaron si vijon,

1. **GVJ** , tabela përmbledhëse , numri i studentëve tre vitet e fundit janë gjithsej 36 studentë.

Komente nga GVB

Përmbledhja e të dhënave të raportit është shkruar një lapsus, i cili mund të ndreqet lehtësisht. Për saktësim të dhënash, paraqesim dhe njëherë numrin e studentëve për këtë program:

-viti akademik 2022-2023 8 studentë

-viti akademik 2021-2022 0 studentë

-viti akademik 2020-2021 15 studentë

-viti akademik 2019-2020 14 studentë

Komente nga GVJ

Saktësojmë se numri i studentëve për tre vitet e fundit është gjithsej 23 studentë. Ky lapus rregulluar në tabelen përmbledhëse.

2. GVJ Standardi I,2 kriteri 2, konkluzioni

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në dosje konstatojmë se Departamentet përgjegjëse, ai i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Gazetarisë, ofrojnë bashkëpunimë me institucione të specializuara dhe në funksion të efikasitetit të programeve që ofron niveli “Bachelor në GJSHL”. Pikërisht për të arritur realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi të lidhura në nivel institucional nga Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan me institucione të ndryshme universitare dhe kërkimore shkencore, që ofrojnë programe të ngjashme studimi, si edhe institucione që kanë si objektiv arkivimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike. Përmendim këtu marrëveshjen me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Arkivin Qendror Shtetëror, Arkivin Digjital të Elbasanit etj.

Konkluzioni

Për realizimin e procesit akademik, departamentet që mbulojnë programin kanë realizuar marrëveshje me institucione të rëndësishme Shkencore, Arsimore dhe Instiucione shtetërore. Nuk ka evidencime për marrëveshje me institucione jo publike.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.

Komente nga GVB

Marrëveshja me Arkivin Digjital të Elbasanit provon bashkëpunimin institucional jo publik

Komente nga GVJ

Në evidenca dhe në raporte nuk saktësohet që Arkivi Digjital të Elbasanit është insitucion jopublik. Pavarësisht këtij konfirmimi GVJ vlerëson se ky bashkëpunim është i pamjaftueshëm për realizimin e procesit akademik.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

3. GVJ Standardi II kriteri 2

Standardi është vlerësuar me vlerësimin përmbushet plotësisht dhe është shprehur masa e përmbushjes së standardit

Komente nga GVB

Standardi II, pika 2, nuk tregohet se në ç'masë përmbushet standardi. Kjo është me shumë mundësi një lapsus që mund të ndreqet lehtë. Standardi 2.2 e ka të shkruar përmbushjen e standardit me vlerësimin "përmbushet plotësisht".

Komente nga GVJ

Standardi është vlerësuar me vlerësimin përmbushet plotësisht dhe është shprehur masa e përmbushjes së standardit

4. GVJ Standardi IV kriteri 2, konkluzione

GVJ

Institucioni i arsimit të lartë ka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. Vizita në terren konfirmoi të dhënat e paraqitura në raport. Laboratorët, biblioteka dhe mjediset mësimore janë të përshtatshme dhe në shërbim të studentit. Ka ende vend për përmirësim të ambienteve (klasave mësimore) për pajisje që i dedikohen procesit mësimor që të jenë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme.

GVJ sugjeron një lidhje të qëndrueshme Eëifi, që të shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimit dhe që të ndihmojë zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies.

GVJ sugjeron gjithashtu që ambientet e mësimdhënies të jenë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe monitorë, të cilat shërbejnë për një procesi mësimor cilësor.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard **përmbushet kryesisht**.

Komente nga GVB

Standardi IV, fusha 3, grupi i ekspertëve të jashtëm sugjeron "një lidhje të qëndrueshme Eëifi, që të shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimit dhe që të ndihmojë zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies. GVJ sugjeron gjithashtu që ambientet e mësimdhënies të jenë të pajisura me kompjuterë, videoprojektorë dhe monitorë, të cilat shërbejnë për një procesi mësimor cilësor. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht." E informojmë grupin e ekspertëve se në mbledhjen e fundit të senatit ku u diskutua buxheti për vitin akademik 2023-2024 është parashikuar edhe vendosja e sistemit eëifi në mjediset universitare.

Ndërsa në lidhje me pajisjen e klasave me mjetet që do të mundësojnë mësimdhënie audiovizive shprehemi se për çdo qershor ne i paraqesim në rektorat kërkesat tona për mjete të tilla dhe do të vijojmë ta bëjmë, deri kur do të përmbushen nevojat tona. Por përmbushja e tyre është diçka që lidhet me vendime përtej departamentit dhe dekanatit.

Komente nga GVJ

GVB ka pranuar vlersimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtejshëm si insitucion për realizimin e tij

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

5. GVJ Standardi IV, kriteri 3, konkluzione

UE disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Konstatohet se sistemet e brendshme të menaxhimit EMS dhe adresat zyrtare të emailit (me @uniel.edu.al) administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative.

Informacioni gjendet në dy gjuhë; Shqip dhe Anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore).

Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:

- Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UE-s në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj
- Përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard **përmbushet kryesisht**.

Komente nga GVB

Standardi IV, fusha 4, konkluzione, ekspertët vlerësojnë informacionet që gjendet në uebin e universitetit se “Informacioni gjendet në dy gjuhë; Shqip dhe Anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore). Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon: Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UE-s në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj; Përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.” Ne shprehemi se do të paraqesim përpara rektoratit, që menaxhon uebin e universitetit informacionet e nevojshme për informimin e studentëve. Gjithashtu do të përpiqemi të kontaktojmë edhe me kolegë të departamentit të gjuhëve të huaja për të pasur një prezantim më të mirë në gjuhën angleze të ofertës sonë akademike.

Komente nga GVJ


GVB ka pranuar vlersimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtejshëm si insitucion për realizimin e tij

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

6. GVJ Standardi V, fusha 4, konkluzione

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim. Institucioni disponon një listë punësimi të studentëve të diplomuar, por prej saj nuk është e qartë se cilës periudhë diplomimi i takojnë. Gjurmimi nuk është Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim. Institucioni disponon një listë punësimi të studentëve të diplomuar, por prej saj nuk është e qartë se cilës periudhë diplomimi i takojnë. Gjurmimi nuk është periodik, si rrjedhojë tabela e të dhënave dhe cilësisë së punësimit nuk është e plotë.

Për rrjedhojë, GVJ rekomandon përmirësimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me punësimin e të diplomuarve të këtij programi specifik studimi.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.

Komente nga GVB

Standardi V, fusha 4, ekspertët e jashtëm shkruajnë se “Për rrjedhojë, GVJ rekomandon përmirësimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me punësimin e të diplomuarve të këtij program specifik studimi.” Në departament do të ngremë një grup pune, i cili do të merret me regjistrimin e të dhënave dhe mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar pranë programeve tona të studimit.

Komente nga GVJ

GVB ka pranuar vlerësimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtjshëm të njësisë bazë për realizimin e tij.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

7. GVJ Standardi V, fusha 6, konkluzione

UE ka hartuar një sërë dokumentesh që mundësojnë sigurimin e barazisë, vlerësimin dhe kontrollin, si regjistri fizik, pasqyra e vlerësimin të studentit, hedhja e të dhënave për vlerësimin e studentit në sistemin e-student , ku student para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit.

Pas periudhës së parashikuar në rregullore, nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.

GVJ sugjeron që në rastet e ankimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë të regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në Departament ose në Dekanat.

GVJ sugjeron që raportin vjetor të aktivitetit akademik, të cilin UE e paraqet pranë MASR dhe e publikon, t’ua bëjë të ditur edhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard ***përmbushet kryesisht.***

Komente nga GVB

Standardi V, fusha 6, ekspertët sugjerojnë“që në rastet e ankimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë të regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në Departament ose në Dekanat. GVJ sugjeron që raportin vjetor të aktivitetit akademik, të cilin UE e paraqet pranë MASR dhe e publikon,t’ua bëjë të ditur edhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.” Dhe në departament do të nxisim përfshirjen edhe më të madhe të studentëve në analizat e programeve dhe të performancës së stafit akademik të programit të studimit.

Komente nga GVJ

GVB ka pranuar vlerësimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtejshëm të njësisë bazë për realizimin e tij.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

8. GVJ Standardi VI, fusha 4, konkluzione

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit dhe performancës e pedagogëve është një proces tërësisht ligjor dhe që respekton në maksimum integritetin njerëzor dhe akademik të çdo individi dhe shmang maksimalisht çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik e jo akademik dhe studentëve.

GVJ konfirmon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit në vlerësimin e brendshëm të cilësisë tij. Praktikisht, studentët janë pjesë e qeverisjes së Universitetit të Elbasanit, nëpërmjet prezencës së përfaqësuesve të tyre në Senat, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë, Këshillin studentor dhe Komisionin e etikës.

Konkretisht, studentët e Dgj dhe DLG nuk ishin plotësisht të përfshirë dhe të njohur me strukturat e cituara më sipër, por ata shprehin opinionet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet angazhimit periodik në anketimet studentore.

Gjatë komunikimeve me dekanen, GVB-në dhe stafin akademik nuk u konfirmua strategji për tërheqjen e bashkëpunëtorëve, apo ekspertëve të jashtëm për mendime të specilizuara në lidhje me cilësinë e programit.

Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard **përbushet kryesisht.**

Komente nga GVB

Standardi 6, fusha 4, ekspertët e jashtëm “Gjatë komunikimeve me dekanin, GVB-në dhe stafin akademik nuk u konfirmua strategji për tërheqjen e bashkëpunëtorëve, apo ekspertëve të jashtëm për mendime të specilizuara në lidhje me cilësinë e programit. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet kryesisht.” Një ide për tërheqjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm, në kushtet kur nuk ka buxhet për përfshirjen e tyre në vlerësimin e brendshëm, mund të jetë kërkimi i bashkëpunimit me ish- të diplomuar të programit të studimit, që kanë tashmë një karrierë akademike ose në fusha të tjera që lidhen me administrimin e arsimit edhe të mesëm të lartë.

Komente nga GVJ

GVB ka pranuar vlerësimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtejshëm të insitucionit për realizimin e tij.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

9. GVJ Standardi VI, fusha 5, konkluzione

U konfirmua prezenca e një sërë raportesh nga struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë; raporte të analizës vjetore të njësisë bazë dhe raport i NJSBC për vitin akademik 2020-2021. Në raportet e

analizave vjetore janë diskutuar gjetjet e strukturave të sigurimit të cilësisë dhe janë parashikuar masa për përmirësimin e problematikës së vërejtur lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Mbledhjet e departamentit, shërbejnë për njohjen me arritjet, mangësitë, problematikat dhe praktikat lidhur me sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

GVJ sugjeron që Institucioni të organizojë më shumë veprimtari me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, të realizojë veprimtari për trajnimin e stafit në kërkimin shkencor.


Komente nga GVB

Standardi 6, fusha 5, ekspertët e jashtëm sugjerojnë “që Institucioni të organizojë më shumë veprimtari me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, të realizojë veprimtari për trajnimin e stafit në kërkimin shkencor.” Departamenti dhe dekanati, të nxitur edhe prej kërkesave të standardeve të cilësisë së arsimit të lartë dhe gjithashtu edhe nga bisedat me kolegët kanë menduar të paraqesin në rektorat kërkesa për trajnime profesionale, kryesisht në përdorimin e teknologjisë në kërkimin shkencor dhe në hartimin e projekteve kërkimore, për të thithur fonde kërkimore nga BE-ja.

Komente nga GVJ

GVB ka pranuar vlerësimin e standardit dhe shprehet për angazhim të mëtejshëm të insitucionit për realizimin e tij.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Pas verifikimit të dokumentacionit dhe programit përkatës që kërkohet të akreditohet, konstatojmë se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL) ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtarë. Në këto programe studimi synohet ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike e kulturore kombëtare. Një fakt i tillë sanksionohet edhe në nenin 2 të Statutit të UNIEL. Departamenti i gjuhësisë dhe ai i letërsisë dhe gazetarisë, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, UE “A. Xhuvani” ofrojnë programe studimi, që janë në përputhje me vizionin e arsimit të lartë të shprehur në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, u shërben interesave kombëtarë dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Pas konsultimit të dosjes dhe dokumenteve përkatëse konstatojmë se programi Bachelor në “Gjuhë shqipe dhe letërsi” (Bachelor në GJSHL) është një program studimi, që ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Elbasanit “A.Xhuvani”, të Fakultetit të Shkencave Humane.</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje dhe në mbështetje të misionit dhe qëllimit të departamentit të gjuhësisë dhe të letërsisë dhe gazetarisë, që lidhen me fushën e gjuhësisë, të albanologjisë dhe të studimeve letrare në fushë të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL; 1.3 Strategjia e UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i></p>


<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Konstatohet se programi i studimit “Bachelor në GJSHL” është hartuar në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të UE “A.Xhuvani”, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe strategjive të zhvillimit të departamenteve përkatëse; të Statutit të Universitetit “A.Xhuvani” dhe Rregullores së UE “A.Xhuvani”, të FSHH-së dhe të departamenteve përkatëse, si dhe me fushat e drejtimeve të tyre akademike, në rastin e këtij programi me fushën e gjuhësisë, të albanologjisë dhe të studimeve letrare në fushë të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; 1.3 Strategjia e UNIEL; 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij konkretisht në ambientet fizike përkatëse konstatohet se programi “Bachelor në GJSHL” është ndër programet e para të hapura në këtë universitet. Ai ka rreth 50 vite që ofrohet nga ky institucion dhe nga departamenti përkatës. Departamenti i gjuhësisë, i letërsisë dhe gazetarisë përbëhet nga një staf akademik me përvojën dhe titujt akademikë të kualifikuar dhe me veprimtari kërkimore serioze në fushat që lidhen me këtë program; gjuhësi e studime letrare.</p> <p>Një gjë e tillë krijon siguri dhe plotëson një ndër standardet kryesore të kërkuara për akreditim.</p> <p><i>Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; Evidenca 1.26 Urdhër “Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane”; Evidenca 1.27 Urdhri për hapjen e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.18 Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik në kuadër të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit vëmë re se departamenti i gjuhësisë, i letërsisë dhe gazetarisë si njësi bazë të FSHH-së, ofron programe studimi në fushë të gjuhësisë, albanologjisë, fushave ndërdisiplinore (psikolinguistikë, sociolinguistikë, etnolinguistikë etj), në fushë të studimeve letrare, të historiografisë së letërsisë shqiptare dhe asaj botërore, si dhe “Bachelor në GJSHL”.</p> <p>Një përfshirje e tillë kompetencash është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHH-së, si dhe të departamenteve përkatëse. Gjuhësia është pjesë e shkencave humane dhe studimet letrare, po ashtu diploma i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ciklit të parë të studimeve universitare me numrin unik të identifikimit 000088 në regjistrin e diplomave të regjistruara në Ministrinë e Arsimit në Republikën e Shqipërisë.</p>

	<i>Evidenca 1.28 Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.30 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se për programin e studimit, fushat e tij të përgjithshme dhe specifike janë plotësisht në përputhje me misionin e arsimit të lartë, si e mirë publike dhe në përputhje me misionin dhe qëllimin e e UNIEL, duke synuar plotësisht ruajtjen e vlerave dhe interesave kombëtare. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita e kryer nga komisioni i ekspertëve të jashtëm, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së akreditimit, vëm re se UE siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njërive e personelit. Kjo në kuadrin e hartimit, mbikëqyrjes dhe mbarëvajtjes së programit.</p> <p>Departamentet përgjegjëse, ai i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Gazetarisë, për ofrimin e “Bachelor në GJSHL” bashkëpunojnë ngushtësisht për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, bashkëpunim të rregulluar dhe të përcaktuar edhe në rregulloret përkatëse të departamenteve, në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë.</i></p> <p>Në këto rregullore sanksionohet pozicioni i departamentit të gjuhësisë, si njësi që përfaqëson programin në njësi më të larta, si dekanati, rektorati dhe Senati i UE-së. Departamentet përgjegjëse bashkëpunojnë dhe me departamente të tjera të FSHH-së (si ai gjuhëve të huaja) dhe të njërive të tjera të UE “A. Xhuvani” për lëndë të tipologjive të ndryshme që ofrohen në këtë program.</p> <p>Po sipas këtyre rregulloreve, në fund të çdo viti mësimor departamentet e analizojnë këtë bashkëpunim dhe realizimin e programit në mbledhjet e analizës së punës mësimore.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit</i></p>





	<p>të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" për vitin akademik 2020-2021.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në dosje konstatohet se Departamentet përgjegjëse, ai i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Gazetarisë, ofrojnë bashkëpunimë me institucione të specializuara dhe në funksion të efikasitetit të programeve që ofron niveli "Bachelor në GJSHL". Pikërisht për të arritur realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi të lidhura në nivel institucional nga Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan me institucione të ndryshme universitare dhe kërkimore shkencore, që ofrojnë programe të ngjashme studimi, si edhe institucione që kanë si objektiv arkivimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike. Përmendim këtu marrëveshjen me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Arkivin Qendror Shtetëror, Arkivin Digital të Elbasanit etj.</p> <p><i>Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" për vitin akademik 2020-2021. Evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave; Shih Tabela 5 tek Aneksi i Tabela Përmbledhëse - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vëm re se në vitin e tretë të studimeve, semestri i dytë, realizohet praktika në formën e ekspeditës gjuhësore në terren, e cila synon të përmirësojë, orientojë dhe të testojë dijet gjuhësore përgjatë 3 viteve të studimit në terrenin e kërkimit të faktit gjuhësor. Procedura e realizimit të këtij procesi konstatohet se është si në vijim: Për realizimin e kësaj praktike, departamenti paraqet në rektorat në muajin Qershor të çdo viti akademik kërkesat e përgjithshme financiare për transportin dhe fjetjen e studentëve, sipas itinerarit të ekspeditës, të parashikuar në silabusin e lëndës. Në fillim të vitit akademik departamenti i paraqet rektoratit listën e studentëve dhe itinerarin përkatës dhe zyra financiare pranë rektoratit siguron me anë të prokurimit shërbimin e transportit dhe të fjetjes.</p> <p><i>Evidenca 1.37 Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore Evidenca 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi".</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dosjes së këtij programi, konstatuam se në të gjenden dokumente që faktojnë se departamentet e gjuhësisë dhe të letërsisë dhe gazetarisë me përfundimin e vitit akademik hartojnë raportin e analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve përkatëse të studimit, që ofrojnë, dhe sigurisht të përfshirë në të dhe për "Bachelor në GJSHL".</p>



	<i>Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i>		
Konkluzione	<i>Për realizimin e procesit akademik, departamentet që mbulojnë programin kanë realizuar marrëveshje me inistitucione të rëndësishme Shkencore, Arsimore dhe Instiucione shtetërore. Nuk ka evidencime për marrëveshje me institucione jo publike. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislationin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga konsultimi i detajuar i dosjes për akreditim, konstatohet se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” është i organizuar në lëndë dhe module në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 80/2015 Ligji Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të cilat janë të vlerësuara në kredite, bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ETCS).</p> <p><i>(Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL)</i></p> <p>Po sipas kësaj dosjeje dhe dokumenteve specifike të saj, pohojmë se programi është i organizuar në tri vite akademike, 60 kredite për çdo vit akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 180 kredite (ECTS) dhe merr diplomën universitare “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”, i cili përputhet plotësisht me strukturën e Sistemit të Bolonjës.</p> <p><i>(Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi”; Tabela 3 - Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin I, II dhe III të studimeve, që ofrohen në njësinë përgjegjëse (struktura e programeve të studimit në FSHH)</i></p> <p>Për çdo lëndë përlogariten ECTS përkatëse dhe caktohen në planet mësimore të lëndëve. Programi përmban kategoritë e veprimtarive formuese (lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, plotësuese, detyrime përmblylëse) që karakterizojnë programin “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”)</i></p> <p>Plani mësimor përmban ndarjen e moduleve në semestra, raportin teori-praktikë dhe numrin e krediteve për secilin modul, i cili shpreh volumin e punës mësimore në auditor dhe të punës individuale për arritjen e rezultateve të pritshme. Mbarëvajtja e këtyre veprimtarive rregullohet përmes rregulloreve të programit.</p> <p><i>Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”. (Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të</p>	<p>Në dokumentacionin që gjendet në dosje theksohet se programi i studimit “Bachelor GjSHL” përgatit njohës të thelluar në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë, duke i pajisur me njohuri të thella mbi shkencën e gjuhësisë dhe letërsisë, që u mundësojnë qasjen me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>profesione e specialitete të ndryshme dhe të vijojnë studimet në programe studimi të ciklit të dytë për të ushtruar më tej profesione si mësues, redaktor, punonjës në arkiva; si punonjës në biblioteka; si specialistë të gjuhës në radio e televizione etj. Në këtë mënyrë fryma e këtij programi përputhet me kriterin përkatës.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi".</i></p> <p>Po duke u mbështetur në dokumentacionin që gjendet në dosje, shohim se synimi i këtij programi është që të krijojë të nxënësit kompetenca solide e të thelluara si nga ana teorike, ashtu dhe praktike. Në këtë mënyrë, ai përqipet të zhvillojë tek ata aftësi e kompetenca në disiplina shkencore që shtrihen në fushat e gjuhësisë dhe letërsisë. Organizimi i programit studimor në grupe mësimore-kërkimore ndjek përgjithësisht një logjikë të tillë, duke bërë bashkë staf akademik me profile që i korrespondojnë grupit, me synimin për të përmirësuar dhe ndjekur mbarëvajtjen e programit. Të diplomuarit në këtë degë fitojnë aftësi për të vijuar më tej karrierën akademike në ciklet e dyta dhe të treta të studimit.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Tabela 3 - Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin I, II dhe III të studimeve, që ofrohen në njësinë përgjegjëse (struktura e programeve të studimit në FSHH.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes na rezulton se në mbështetje të akteve ligjore dhe rregullatore kombëtare, programi i studimit "Bachelor në Gjuhë shqipe-letërsi" organizohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Lëndë bazë – 30 kredite = 16.6% të totalit të krediteve. Lëndë karakterizuese – 96 kredite = 53.3% të totalit të krediteve. Lëndë ndërdisiplinore/integruese- 23 kredite = 12.7% të totalit të krediteve. Lëndët plotësuese- 25 kredite = 13.8% të totalit të krediteve. Detyrime përmbyllëse – 6 kredite = 3.3% të totalit të krediteve. <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi").</i></p> <p>Për secilën lëndë/modul në program dallohet nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Shpërndarja e lëndëve dhe krediteve për çdo lëndë është në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17</i></p>

	<p><i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar materialt që gjendet në dosjen për akreditim, konstatohet se programi i studimit “Bachelor në gjuhë shqipe-letërsi” (BGJSHL) ofron praktikën profesionale në fund të vitit të tretë akademik nëpërmjet lëndës “Ekspeditë gjuhësore”. Në planin e BGJSHL është përcaktuar ngarkesa e krediteve të lëndës së praktikës dhe format e detyrimeve përmbyllëse për këtë lëndë.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.37 Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit që gjendet në dosje konstatohet se forma e organizimit të studimeve që pasqyrohet në rregulloren e programit të studimit është konform akteve ligjore dhe nënligjore të shtetit shqiptar. Po kështu, format e financimit për studentët realizohen nëpërmjet bursave dhe përjashtimit nga tarifa e studimit. Bursat jepen në përputhje me kriteret ligjore: për studentët ekselentë dhe studentët përfitues sipas kriterit ekonomik. Procesi i dhënies së bursave realizohet në fillim të vitit akademik dhe procedura e përfitimit të bursave vijon pas vendimit të Bordit të Administrimit.</p> <p><i>Evidenca Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga përqasja e dokumentacionit që gjendet në dosje me kurrikulat e universiteteve të tjera shqiptare vërejmë se programi i studimit BGJSHL që ofrohet nga departamenti i gjuhësisë dhe ai i letërsisë dhe gazetarisë është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Elbasanit “A. Xhuvani”, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe me misionin dhe qëllimin e departamenteve përkatëse. Ai lidhet me fushën e gjuhësisë, të albanologjisë, të studimeve letrare dhe historiografisë së letërsisë. Ky program është i ngjashëm me programe të tjera të studimit që ofrohen në Universitetin e Tiranës, Universitetin e Shkodrës, Universitetin e Korçës, të Vlorës, të Durrësit, si edhe me universitete të tjera të trevave shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Veriut. Kjo ngjashmëri ka lidhje me fushën e njëjtë të studimit (gjuhësi, albanologji dhe studime letrare).</p> <p><i>Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit BGJSHL; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “BGJSHL”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “BGJSHL”.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve</p>	<p>Dokumentacioni që gjendet në dosje vërteton se programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	kodifikimi i lëndëve të programit, duke përcaktuar kodin përkatës të çdo lënde. Kodifikimi i lëndëve të programit të studimit behet, duke përdorur akronimet e programit të studimit (GJL), pastaj një vizë, dhe të lëndëve përkatëse (HGJ, p.sh. në rastin e Hyrjes në Gjuhësi), pastaj vizë, dhe pastaj vitin kur zhvillohet lënda (p.sh. GJL-HGJ-21). <i>Evidenca 1.27 Urdhri për hapjen e programit të studimit “Bachelor Gjuhë-Letërsi”; 1.8 Rregullore e programit të studimit BGJSHL; 3.16 Plani mësimor i programit; 3.17. Programet mësimore të lëndëve.</i>		
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në lidhje me këtë kriter nuk ofrohen të dhëna në dosje, pra do të thotë se nuk ka të realizuar.		
Konkluzione	<i>Programi i studimit organizohet plotësisht në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore të përcaktuara nga MAS dhe UE. Ky program është në përfaqje deri në masën 80% me kurrikulat e universiteteve të tjera shqiptare që ofrohen në Universitetin e Tiranës, Universitetin e Shkodrës, Universitetin e Korçës, të Vlorës, të Durrësit, si edhe me universitete të tjera të trevave shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Veriut. Kjo ngjashmëri ka lidhje me fushën e njëjtë të studimit (gjuhësi, albanologji dhe studime letrare). Forma e organizimit të studimeve që pasqyrohet në rregulloren e programit të studimit është konform akteve ligjore dhe nënligjore të shtetit shqiptar. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në dosjen për akreditim, konstatojmë se departamenti i Gjuhësisë dhe departamenti i letërsisë dhe gazetarisë (pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane) që ofrojnë programin e studimit “Bachelor në GJSHL” plotësojnë kriteret sipas ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” <i>(Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL).</i> Në dosje dokumentohet se Departamenti i Gjuhësisë ka 5 (pesë) personel akademik të kategorisë “Profesor”, prej të cilëve 1 (një) me titullin akademik “Profesor doktor” dhe 4 (katër) me titullin akademik “Profesor

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>i asociuar”; 3 (tre) personel akademik të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor i shkencave”. Nga këta, 6 prej tyre janë të përfshirë në mësimdhënien universitare në këtë program.</p> <p>Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë ka në përbërjen e tij 2 (dy) personel akademik të kategorisë “Profesor” me titullin akademik “Profesor i asociuar”; 6 (gjashtë) personel akademik të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor i shkencave”; 3 (tre) personel akademik të kategorisë “asistent lektor”. Nga këta, janë të përfshirë në mësimdhënien e këtij programi 8 pedagogë.</p> <p><i>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHH-së; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.21 Vendimi për hapjen e departamentit të gjuhësisë; Tabela 1 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që përmban dosja mund të pohojmë se programi i studimit “Bachelor në GJSHL” përmban edhe anën praktike të zbatimit të njohurive gjuhësore, që lidhet me ekspeditën gjuhësore në terren, të realizuar në semestrin e dytë të vitit të tretë të studimit, si dhe laboratorë për lëndët që lidhen me shtypshkrimin e standardit.</p> <p>Departamenti nuk ka të angazhuar në personelin e vet staf ndihmës-akademik. Në ekspeditën që zhvillohet në vitin e tretë, pedagogët i shoqërojnë vetë studentët, duke i udhëzuar për mbledhjen e materialit, kontaktin me informatorin gjuhësor etj. Ndërsa për laboratorët e Shqipes Standarde përdoret laboratorin e gjuhëve të huaja pranë FSHH-së.</p> <p><i>Evidenca 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.37. Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në dokumentacionin që gjendet në dosje theksohet se në kuadër të organizimit dhe mirëfunksionimit të veprimtarisë së departamentit, dhe në përbushje të detyrimeve ligjore ecuria dhe zhvillimi i programit “BGJSHL” koordinohet nga drejtuesi i departamentit të gjuhësisë, i cili së bashku me drejtuesin e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë, të cilët janë dhe koordinatorët akademikë të programit. Njësia bazë ka caktuar dhe një koordinator për programin e studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij dhe ka të përshkruara detyrat e tij.</p> <p><i>(Evidenca 1.24 Vendim për caktimin e koordinorit të programit të studimit; Evidenca 1.25 Përshkrimi i detyrave të koordinorit të programit të studimit BGJSHL).</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


Konkluzione	<p>Konstatohet gjerësisht dhe në mënyre të detajuar nëpërmjet dokumentacionit se programi i studimit është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Programi ka dy bashkëkordinatorë nga dy departamentet, të cilët ndjekin ecurinë e tij konform rregullores së programit.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet .</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se FSHH disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit BGJSHL në lidhje me: planin strategjik të programit të studimit, rregulloren e brendshme, rregulloren e diplomimit, të sekretarisë, rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe të bibliotekës. Informacionet janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB.</i></p> <p>Po kështu nga materialet e dosjes mund të pohojmë se departamentet disponojnë informacionet e nevojshme mbi rregulloren e programit të studimit, rregulloren e departamentit, strategjinë departamentit, rregullat e diplomimit, rregullore e zhvillimit të ekspeditës gjuhësore, të cilat u mundësohen studentëve dhe të interesuarve nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në dosjen për akreditim jepet informacion i mjaftueshëm mbi planin mësimor për programin “BGJSHL”, në të cilin përfshihen të dhëna në lidhje me: ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor, që zënë përbërësit mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, forma të kontrollit të vazhduar etj. Përbërësit mësimorë në planin mësimor të programit “BGJSHL” përfshijnë orë në auditor dhe ato jashtë auditorit. Orët jashtë auditorit përfshijnë orët e studimit individual. Orët në auditor dhe orët jashtë auditorit së bashku përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studime në këtë program, është 60</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>kredite x 25 orë mësimore për kredit = 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore punë të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e Programit të Studimit BGJSHL; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në dosjen për akreditim gjendet rregullorja e programit të studimit BGJSHL, e cila përmban informacionet e duhura për studentët, që janë të interesuar ta ndjekin apo janë regjistruar në të. Këto informacione, si: kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, janë të hartuara dhe të mbështetura mbi një bazë rregullatore ligjore (rregulloret e UE-së, FSHH-së, departamentit të gjuhësisë dhe të letërsisë dhe gazetarisë) dhe iu ofrohen studentëve nga strukturat përgjegjëse të FSHH-së, siç janë: dekanati, departamenti i gjuhësisë, koordinatori i programit të studimit, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor i FSHH-së.</p> <p>Në dosje theksohet se pranimi i studentëve në programin e studimit kryhet në mbështetje të akteve ligjore në fuqi. Çdo vit akademik njësia bazë përcjell për miratim propozimet për kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve në programet që ofron, kuotat e transferimit të studentëve në UE, bazuar në kapacitetet pritëse dhe akademike sipas përcaktimeve ligjore, të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe dërgohen në QSHA. Kriteret dhe kuotat e pranimit bëhen publike përmes publikimit të vendimeve në faqen zyrtare të UE-së, publikimit të kuotave e kriterëve në portalin U-Albania, faqeve zyrtare në rrjetin social Facebook të departamentit të gjuhësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit Evidenca 1.7 Rregullore e studimeve të FSHH-së; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes arritëm në konkluzionin se programet e lëndëve të programit të studimit (syllabuset) kanë në strukturën e tyre informacionet e nevojshme për lëndën, emërtimin/kodin e saj, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.), tipologjinë e lëndës, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje), programin e studimit ku ofrohet, adresën elektronike të titullarit/e pedagogut të lëndës, temat që përfshihen, mënyrën e kontrollit të dijes (frekuentimin dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve), literaturë bazë, e detyrueshme dhe e rekomanduar.</p> <p>Ky format është bërë në përputhje me formatet e miratuara sipas akteve ligjore dhe rregullatore dhe është depozituar në departament pas miratimit</p>



	nga drejtuesi i njësisë bazë/kryesore, si dhe i është komunikuar studentit në fillim të viti akademik.		
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Sipas dokumentacionit dhe bisedës në ambientet e Universitetit vërejtëm se përmbajtja e programit të studimit BGJSHL shihet si një proces që është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe fund të vitit akademik ai i nënshtrohet diskutimeve në departamentet përkatëse, ku bëhen propozimet për ndryshime. Këto ndryshime përfshijnë edhe programin lëndor, duke reflektuar në përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, metodologjisë etj, dhe kurrikulën, duke sugjeruar ndryshime në funksion të përmirësimit të saj apo përshtatjeve me ndryshimet ligjore.</p> <p><i>Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” (në 3 vite).</i></p> <p>Të gjithë ndryshimet, sipas dokumenteve që gjenden në dosje, kryhen përmes analizës vjetore të departamenteve përgjegjëse, diskutimit dhe miratimit në departament. Ndryshimet e propozuara kalojnë për miratim në Senatin Akademik të UE “A. Xhuvani”.</p> <p><i>(Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” për vitin akademik 2020-2021).</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Nga evidencat, materialet në dispozicion dhe vëzhgimi në terren konstatohet se programi është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dosjes na rezulton se programi “BGJSHL” përmban lëndë të emërtuara dhe grupuara në përshtatje me emërtimin e programit. Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit “BGJSHL” mundësojnë njohuri të përparura gjuhësore, kulturore e letrare, formim shkencor në fushat e gjuhësisë dhe nëndisiplinave të saj, shkencës për letërsinë e fushave të ndryshme të studimit letrar, përmes lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese dhe plotësuese.

	<p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p> <p>Po sipas dokumentacionit, programi në tërësi u përgjigjet një sërë kompetencash, që synojnë zhvillimin dhe aftësimin e studentëve për të thelluar studimet më tej apo për t’u punësuar si punonjës në arkiva, si punonjës në biblioteka, si redaktorë në shtëpi botuese, si specialistë të gjuhës në radio e televizione etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi”).</i></p> <p>Lëndët e programit mundësojnë njohuri dhe aftësi në fusha specifike të programit të detajuara në silabuset e lëndëve. Përbërësit mësimorë, si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/inovator dhe kritik, zhvillimit të aftësive komunikuese, njohurive shkencore e profesionale në përshtatjen më të mirë në tregun e punës dhe punësimin e tyre.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë).</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, vëmë re se lëndët / modulet në programin “BGJSHL” janë shpërndarë në mënyrë të tillë që t’u përgjigjen kompetencave të propozuara të programit me synimin e arritjes së rezultateve të të nxënit, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Lëndët janë të vlerësuara në kredite.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p> <p>Në përgjithësi shpërndarja e lëndëve respekton raportin teori-praktikë, si dhe ndarjen sipas viteve të studimit të lëndëve bazë, karakterizuese, integruese dhe ndërdisiplinore. Përgjatë programit ofrohet dhe praktika profesionale, e cila e sfidon studentin për të zbatuar njohuritë e marra gjatë programit në praktikë. Sipas organizimit të lëndëve për vitet e studimit, studenti forcon parimet teorike dhe praktike që zërthehen në programin e studimit, duke i dhënë aftësi dhe kompetenca.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstatojmë se struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë, ngarkesa e krediteve është në përputhje me profilin e programit të studimit, duke u mbështetur në përvojën e personelit akademik dhe i përafërt me programe të ngjashme</p>




<p>studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>ndërkombëtare, nisur nga trajtimi i disiplinave kryesore, si disipinat e gjuhësisë: fonetika, semantika, sintaksa, morfologjia, gjuhësia e përgjithshme dhe, nga ana tjetër, studimet në letërsi të krahasuar, shkencën e letërsisë, njohuritë nga letërsia botërore etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit që gjendet në dosjen për akreditim, konstatohet se plani mësimor i programit të studimit “BGJSHL” parashikon ndarjen e lëndëve në përputhje me kërkesat ligjore, duke ruajtur raportet midis formimit teorik dhe praktik, duke mundësuar arritjen e objektivave formuese. Programi paraqet shpërndarje të ngarkesës mësimore në mënyrë të qartë, duke mundësuar pjesëmarrjen e studentëve në praktika profesionale. Ngjashmëria e profilit të programit të studimit me universitetet shqiptare dhe ndërkombëtare, krijon mundësinë e transferimit të studimeve në universitete me programe të ngjashëm si, në Universitetin e Tiranës, në Universitetin e Shkodrës, në universitetet e Vlorës, Durrësit, Korçës etj., në universitete në Republikën e Kosovës, si në atë të Prishtinës, Gjakovës, Prizrenit etj. Gjithashtu studentët mund të ndjekin semestra në programe studimi në fushë të letërsisë dhe gjuhësisë në universitete të ndryshme të huaja.</p> <p>Në lidhje me punësimin në përfundim të ciklit të parë të studimeve, ata mund të punësohen pranë administratës publike dhe private në detyra që lidhen me aftësitë e zotërimit të standardit dhe të komunikimit publik.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Dokumentacioni që gjendet në dosje pohon faktin se programet e lëndëve /moduleve (silabuset) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> <p>Aty pohohet se në fillim të çdo viti akademik, në departamentet përgjegjëse për këtë program studimi rishikohen, diskutohen dhe miratohen silabuset e çdo lënde të këtij programi. Përditësimi i literaturës, reflektimi i ndryshimeve që vijnë nga kërkesat e studentëve dhe studiuesve të rinj dhe të produktit shkencor të stafit të departamenteve pasqyrohet në këto silabuse dhe në temat përkatëse të tyre.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi; Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.		
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Në përgjithësi ne konstatojmë se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, duke i përgatitur studentët në mënyrën e duhur të pranohen në programet e nivelit të dytë të studimit “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në programe studimi në fushë të gjuhësisë, studimeve letrare, trashëgimisë kulturore, komunikimit, gazetarisë etj dhe të përshtaten me tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; 1.8 Rregullore e programit të studimitBGJSHL; 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit BGJSHL; 3.16 Plani mësimor i programit të studimitBGJSHL; 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit BGJSHL.</i></p>		
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Në varësi të dokumentacionit, konstatojmë se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit BGJSHL mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve, duke i përgatitur studentët në mënyrën e duhur të pranohen në programet e nivelit të dytë të studimit. Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program orientohen drejt zbatimit të njohurive si specialist dhe njohës i thelluar në fushë të gjuhësisë dhe të letërsisë, vijimit të studimeve të mëtejshme të specializuara në fushë të mësuësive në këto fusha, në fushë të kërkimeve shkencore në këto fusha. Gjithashtu, programi shërben për të ndihmuar studentët që njohuritë e tyre t’i zbatojnë në disiplina të tjetra, si: gazetari, redaktori dhe punonjës i trashëgimisë kulturore.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programitBGJSHL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimitBGJSHL; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit BGJSHL; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimitBGJSHL; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit janë plotësisht në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Njohuritë e fituara nëpërmjet programit mundësojnë rezultate shumë të mira të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve. Programi mundëson zhvillimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, sipas objektivave që ai ka në strategjinë e tij. Në ndihmë të tij relizimit të kompetencave është edhe ekspedita në terren e cila mundëson njohje praktike të njohurive teorike. Gvj sugjeron munësinë për organizimin e krediteve të lira të zgjedhura nga studentët në ndihmë të zhvillimit të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Në dokumentacionin që gjendet në dosje pohohet se për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit BGJSHL dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, departamentet përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Për realizimin e proceseve të tilla, departamenti organizon veprimtari shkencore, fokus-grupe dhe ditë ta hapura.</p> <p>Në këtë kontekst, dy departamentet në fund të çdo viti akademik organizojnë diskutime mbi përmbajtjen e programit të studimit. Departamentet zhvillojnë pyetësorë me studentët që ndjekin këtë program studimi dhe me studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni) në lidhje me çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit MSHGJ, punësimin e tyre etj. Në nivel institucional, realizohet një pyetësor studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga Komisioni i Përhershëm për Standardet e Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “BGJSHL” (në 3 vite); Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes, si dhe vizitës në UE konstatojmë se UE dhe departamentet përgjegjëse nxitin dhe përfshijnë në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mbajnë kontakte dhe konsultohen vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektojnë propozimet e tyre, kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Ky proces realizohet përmes informacioneve dhe burimeve të siguruar nga gjurmimi i studentëve nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Qëndrimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimit realizohet edhe përmes instrumenteve të caktuara, si janë pyetësorët. Ato realizohen nga strukturat e UE-së apo edhe fakultetit dhe departamentit.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se në përgjithësi departamentet përgjegjëse përmirësojnë, përditësojnë, përshtatin programin e studimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>dhe silabuset përkatëse në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme të disiplinave shkencor, por dhe në teknologjinë shkencore që lidhet me fushën e gjuhësisë (fjalorët elektronikë, aplikacionet për korrekturat elektronike, hartimin e këshillimin e korpuseve gjuhësore) në bashkëpunim me rrjete profesionistësh të mësuesve, shoqata dhe institucione publike e private, dhe specialistë të uebit. Organizimi i veprimtarive të ndryshme në fushë të gjuhësisë dhe letërsisë rrit bashkëpunimin dhe mundësinë e punësimit për studentët.</p> <p><i>(Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë; Evidenca 1.36 Politika e marketingut për programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE, DGj dhe DLG nxisin përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre nëpërmjet veprimtarive të ndryshme shkencore, kulturore, pyetsorëve sipas fokus-grupeve. Përfitimet nëpërmjet marrëveshjeve pasqyrohen ne raporte periodike. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Sipas materialeve që paraqiten në dosje vërejmë se në përgjithësi programi i studimit BGJSHL garanton forma të mësimdhënies/nxënies në raportin e duhur midis leksioneve, seminarave, punëve laboratorike, projekteve, detyrave të kursit apo praktikave, etj, përmes të cilave u sigurohet studentëve konteksti i domosdoshëm dhe nevojshëm për të zhvilluar dijet e tyre. Në të vihet re gërshetimi i lëndëve të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues apo plotësues dhe i ndihmon studentët të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale në fushat e studimit që ofron ky program studimi. Funksionimi efikas i lëndësve me zgjedhje do të rriste edhe më shumë cilësinë e mësimdhënies/nxënies.</p> <p>Ndarja e orëve në program është sipas VKM përkatëse.</p> <p>Në mbështetje të procesit të mësimdhënies departamenti organizon dhe ekspeditën gjuhësore, e cila është pjesë e praktikës profesionale për këtë program studimi. Gjatë programit të studimit programohen dhe projekte të veçanta në lëndë të caktuara, ku angazhohen studentët jo vetëm me pjesëmarrje, por me detyra të punuara.</p> <p><i>(Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Tabela 13 - Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve referuese në dosje konstatohet se personeli akademik që jep mësim në degën BGJSHL është në përbushje të procesit mësimor respekton dhe i përgjigjet larmisë së nevojave të studentëve.</p> <p>Në këtë kontekst, stimulohet organizimi i diskutimeve në klasë, me qëllim orientimin e studentëve drejt çështjeve kyçe për përvetësimin e informacionit; organizimi i detyrave të kursit; kontrolleve të pjesshme të dijes dhe mbi të gjitha konsultimet e parashikuara në programet lëndore, janë në përgjithësi të ndërtuara dhe organizuara në funksion të përbushjes së nevojave specifike të studentëve në raport me dijen që marrin në lëndët përkatëse.</p> <p>Përmbajtja e programeve në përgjithësi është koherente dhe ka si pjesë të rëndësishme të vetën parashikimin e përdorimit të metodave alternative të mësimdhënies. Më e dukshme kjo është në lëndët me natyrë karakterizuese dhe plotësuese, që kanë dhe natyrë më praktike e konkrete. Çdo fillim viti departamentet e gjuhësisë dhe ai i letërsisë e gazetarisë organizojnë diskutime për rritjen e cilësisë së mësimdhënies/nxënies.</p>




	<p>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” për vitin akademik 2020-2021).</p> <p>Gjatë viteve akademike të 2019-2020 dhe 2020-2021, që janë dhe vitet e mbylljes së mjediseve të institucioneve për shkak të pandemisë COVID-19, ishin vite sprove, ku dhe janë praktikuar metodat alternative të mësimdhënis/nxënies, të cilat rezultuan relativisht efikase.</p> <p>(Evidenca 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në kuadër të këtij kriteri mund të pohojme se UE zhvillon dhe mbështet mekanizma që i mundësojnë personelit akademik përmirësimin e kompetencave didaktike, duke u mbështetur në rezultatet e të nxënit, të vjela nga format e ndryshme të kontrollit të dijes, si dhe anketimeve të zhvilluara me studentët. UE ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmësakademik pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre. Institucioni është i hapur, kështu, dhe mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme.</p> <p><i>Evidencat: 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/images/Strategjia_2020-2024_per_publicim.pdf; evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+; evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në dosjen për akreditim jepen materiale që pohojnë se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin e studimit BGJSHL, personel me kohë të plotë ose të pjesshme i departamenteve të gjuhësisë dhe atij të letërsisë e gazetarisë, por edhe personeli akademik, pjesë e departamenteve të tjera brenda FSHH-së e më gjerë, shfaqet në një nivel cilësor në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.</p> <p><i>(Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi”).</i></p> <p>Çdo vit akademik, studentët e këtij programi, në fund të ciklit të studimit mbrojnë para komisioneve përkatëse punime temë diplome.</p> <p><i>(Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes konstatohet se për matjen e cilësisë së mësimdhënies në UE përdoren instrumente të përcaktuara qartë, lidhur me vlerësimin e studentëve e të vetë departamentit, në bashkëpunim me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>njësitë e vlerësimit të cilësisë në nivel institucional. Departamenti i gjuhësisë dhe ai i letërsisë e gazetarisë vlerësojnë dhe përmirësojnë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përdorur si instrument monitorimin e cilësisë së mësimdhënies në disa mënyra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sondazheve të studentëve që ndjekin programin e studimeve, të të diplomuarve në këtë program në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; 2. pyetësorit të vlerësimit të performancës së pedagogut, që plotësohet nga studentët e programit të studimit. 3. Rezultatet e arritura nga studentët në provime; 4. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të provimit të përgjithshëm përfundimtar (diplomës). <p>Këto rezultate përdoren nga departamentet për hartimin e politikave të përmirësimit në mësimdhënie.</p> <p><i>(Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" (në 3 vite); Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Evidenca 5.15 Pyetëtori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në dosjen për akreditim gjendet dokumentacion që pohon se në UE dhe FSHH i kushtohet një vëmendje e veçantë zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit me në fokus arritjen e standardeve të cilësisë për të gjitha nivelet e cikleve të studimit. UE ka në përbërje të saj një strukturë ndihmës akademike me funksion kordinimin institucional, kërkimin shkencor dhe projektet. Struktura ka organizuar veprimtari të ndryshme informuese mbi mundësitë që i ofrohen personelit akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në UE është ngritur dhe funksionon Qendra e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL Centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET.</p> <p>Nga takimi me anëtarët e dy departamenteve që zbatojnë programin u konstatua se pedagogët janë pak ose aspak të përfshirë në projektet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, ku institucioni është i përfshirë.</p> <p><i>(Evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 3.5 Marrëveshja për krijimin e qendrës TEAVET)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në rregulloren e programit konstatohet se prej Institucionit garantohej procesi i të nxënies, aftësimit profesional e shkencor me metoda dhe praktika të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. GJV sugjeron më shumë bashkëpunim të strukturave ndihmësakademike me funksion kordinimin institucional, kërkimin shkencor dhe projektet për përfshirjen e studentëve dhe pedagogëve në programet Erasmus, të cilat ndihmojnë edhe në shkëmbimin e</i></p>

	<p><i>eksperiencave më qëllim përvetësimin e modeleve mësimdhënëse bashkëkohore.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në dosjen për akreditim, si dhe nga vëzhgimi në terren GVJ konstaton se gjenden dokumente që pohojnë se kriteret dhe mënyra e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në programin BGJSHL janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e Universitetit të Elbasanit dhe FSHH-së, si edhe në rregulloret përkatëse të departamentit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit parashtrohet modaliteti i vlerësimit, duke u mbështetur në: pjesëmarrjen, realizimin e detyrave të kursit, angazhimin, testimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. Këto të dhëna janë publike dhe njihen nga studentët. Rregullorja e UE-së dhe e FSHH-së mund të gjenden nga studentët dhe publiku në ëëbin e Universitetit, ndërsa ajo e programit të studimit dhe departamentit u shpërndahet studentëve prej koordinatorit të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë).</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dosja dhe vizita në UE konstatohet se studentët informohen në fillim të çdo lënde/moduli nga titullari i lëndës me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve apo të moduleve.</p> <p><i>(Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi").</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të</p>	<p>Ne konstatohet se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Respektivisht, vlerësimi i njohurive ndërtohet jo vetëm përmes provimeve me shkrim, me gojë apo të kombinuara, por edhe përmes detyrave të kursit, kontrolleve të vazhdueshme të dijes etj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al



<p>demonstroj njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>(Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në dosje pohohet se Departamenti i Gjuhësisë dhe ai i Letërsisë e Gazetarisë, si dhe personeli akademik i tyre vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, të cilat identifikohen nga pyetësi i i vlerësimit të përformancës për pedagogët dhe reflektohen në mënyrën e mësimdhënies dhe hartimin e silabuseve të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” (në 3 vite).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në përgjithësi konstatohet se planet mësimore janë në përputhje me objektivat e programit të studimit, ku parashtrohen dhe kërkesat për formësimin e profesionistëve. Në këtë kuadër, format dhe metodat e mësimdhënies paraqiten si: prezantime detyrash, angazhimi në projekte, punët në laborator dhe praktika profesionale inkurajojnë sensin e autonomisë te studentët, të cilët kanë në dispozicion dhe një fond të dedikuar librash. Këto procese pune mbështeten nga personeli akademik, duke krijuar një hapësirë bashkëpunuese të ngushtë midis stafit dhe studentëve, për të rritur më tej formimin dhe vetëbesimin e tyre.</p> <p>UE ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronikë, ku studentët mund të konsultohen me materiale shkencore ndërkombëtare. Studentët kanë në dispozicion një fond librash në Bibliotekën e UNIEL.</p> <p>(Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi”; Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library Evidenca 3.8 Fondi i Librit).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre në nivel insitucioni, fakulteti dhe departamenti.</p> <p>Pikë e fortë është ndjekja e ecurisë së programit, jo vetëm nga drejtuesi i departamentit, por edhe nga kordinatori i programit, roli i së cilit është i konsiderueshëm dhe i qartësuar në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në bazë të materialeve që gjenden në dosjen për akreditim, konstatohet se personeli akademik, i cili zhvillon mësim në programin e studimit BGJSHL, testimin e vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e realizon gjatë gjithë vitit akademik dhe kjo reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Kjo mënyrë e vlerësimit është e parashikuar në silabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive).</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Në dosje nuk dëshmohen të dhëna që testimi kryhet me mjete elektronike, por pohohet fakti se forma e përdorur për realizimin e testeve është e bazuar në letër. Kështu, provimet janë kryesisht me gojë, për shkak të numrit të ulët të studentëve vitet e fundit. Dokumentacioni i provimit ruhet në fletore dhe teste të natyrave të ndryshme.</p> <p>Për grupet që kanë numër të konsiderueshëm studentësh përdoret metoda e sekretimit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim që të ruhet anonimati i studentit. Së fundmi, po përdoren si metoda dhe dorëzimi i detyrave të kursit nëpërmjet adresës elektronike. Ndërsa pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS (EducationManagementSystem).</p> <p>UE zbaton prej disa vitesh dhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, falë bashkëpunimit me projektin CLEANSCORE, të financuar nga AADF. Në programin e studimit BGJSHL nuk përdoren sistemet elektronike të vlerësimit, për shkak të numrit të vogël të studentëve të kursit.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 3.6 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE).</i></p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Në dosjen për akreditim pohohet se vlerësimi përfundimtar i lëndës në programin e studimit BGJSHL bëhet në përputhje me silabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Kjo garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Pasqyrimi i vlerësimit përfundimtar të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS.</p> <p><i>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe</i></p>



	<p>letërsi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas dosjes dhe vizitës në UE konstatohet se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback në rastet e kontrolleve të vazhdueshme të dijeve, prezantimet e detyrave, angazhimit në projekte, realizim detyrash kursi, duke i këshilluar studentët mbi procesin e të nxëniet (arritjet dhe mangësitë e tyre), për ta ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Në programin e studimit BGJSHL testimi i njohurive teorike dhe praktike kryhet edhe përmes detyrave të kursit dhe prezantimeve (provime) me gojë. Në këto prezantime pedagogët kanë mundësi, përmes kontaktit të drejtpërdrejtë dhe konfidencial, të këshillojnë studentin, që të përmirësohet në aftësimin e tij teorik e praktik.</p> <p>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit në BGJSHL).</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në UE konstatohet se departamentet përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin dhe nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Këto detyrime parashtrihen në rregulloret e institucionit dhe Kodin e Etikës, të cilat pasqyrojnë penaltitetet për raste të tilla. Gjithashtu, komisionet e vlerësimit të provimeve, të temave të diplomave dhe udhëheqësit shkencorë të tyre kujdesen në shmangien e kopjimit dhe plagjiaturës në provime dhe në hartimin e detyrave të kursit.</p> <p>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 6.5 Kodi i Etikës UNIEL).</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në mbështetje të dokumentacionit të gjetur në dosje, konstatohet se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë. Ato jepen brenda afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Pedagogu ka detyrim të pasqyrojë notën e studentit në sistemin EMS brenda 6 ditëve të kryerjes së provimit. Dokumentet e provimit të studentëve ruhen për 6 muaj në përputhje me rregulloren.</p> <p>Vlerësimi në mënyrë konfidenciale i komunikohet studentit dhe shënohet në sistemin EMS, në të cilin çdo student ka akses dhe një profil të vetin.</p> <p>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).</p>

<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në dosjen për akreditim gjenden dokumente që vërtetojnë se UE dhe departamentet përgjegjëse për programin e studimit BGJSHL garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë akses në rezultatet personale të provimeve, në respektim të parimit të konfidencialitetit. Nota e provimit i shfaqet studentit brenda 48 orësh në sistemin EMS, dhe studenti mund të kërkojë rishikim të vlerësimit të tij.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes, konstatohet se procedura për ankimimin e studentëve është e pasqyruar në rregullore. Studenti ka të drejtë të paraqesë ankesë për vlerësimin edhe para komisionit të vlerësimit, edhe përpara një instance më të lartë sesa ky komision, si departamenti, dekanati etj.</p> <p>Në rastet kur studentët janë të pakënaqur me rezultatet e vlerësimit, ai paraqet një ankesë pranë drejtuesit të njësisë bazë. Ky i fundit ngre një komision rivlerësimi (i cili nuk është i njëjtë me komisionin e parë), i cili rishqyrton dokumentacionin e provimit në mënyrë transparente. Vendimi i komisionit të rivlerësimit është i formës së prerë dhe depozitohet në departament dhe në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. GVJ konstatoi në terren gjatë vizitës raste të ankimimit të studentëve dhe procedurën, e cila ishte e thjeshtë dhe e arritshme për studentin. Në dosje nuk dëshmohet të dhëna që testimi kryhet me mjete elektronike, por pohohet fakti se forma e përdorur për realizimin e testeve është e bazuar në letër. Kështu, provimet janë kryesisht me gojë, për shkak të numrit të ulët të studentëve vitet e fundit. Dokumentacioni i provimit ruhet në fletore dhe teste të natyrave të ndryshme. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	


<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të</p>	<p>Në dosjen për akreditim konstatohet se ka gërshetim të lëndëve të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues apo</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423




Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



<p>zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>plotësues, që i ndihmon studentët të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale në fushat e studimit që ofron ky program studimi, të cilat përforcohen edhe nëpërmjet laboratorëve dhe zhvillimit të praktikës.</p> <p>Në këtë kontekst programi i studimit BGJSHL garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Konstatojmë, në bazë të dokumentacionit, se tipologjia e lëndëve karakterizuese e plotësuese që ofron ky program zhvillon aftësi të veçanta të studentëve sipas prirjeve të tyre në fushën e gjuhësisë apo të shkencës për letërsinë, por edhe u jep njohuri për përfshirjen e teknologjisë shkencore që lidhet me fushën e gjuhësisë (fjalorët elektronikë, aplikacionet për korrekturat elektronike, hartimin e këshillimit e korpuseve gjuhësore).</p> <p>Në këtë kontekst, programi i studimit BGJSHL synon të garantojë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e shkencave humane, respektivisht në fushë të gjuhësisë dhe të shkencës së letërsisë, si dhe në fushat e komunikimit e të ndërveprimit.</p> <p><i>(Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes, konstatojmë se programi i studimit BGJSHL është ndërtuar mbi formimin e kompetencave dhe aftësive që lidhen me njohuritë bazë për gjuhën shqipe dhe shkencën e gjuhësisë, si dhe mbi historinë e letërsisë (shqiptare dhe botërore) dhe shkencës për letërsinë. Gjithashtu, jepen njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e gjuhës dhe letërsisë, që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde. Të gjitha këto objektiva analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës dhe stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p> <p><i>(Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”).</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes dhe nga vizita në EU konstatojmë se procesi i mësimdhënies në programin e studimit BGJSHL realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të përcaktuara në planet mësimore dhe u japin mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë</p>

<p>akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>dhe praktikat profesionale. Infrastruktura është e përshtatshme dhe në funksion të studentëve për të krijuar një klimë të përshtatshme studimi.</p> <p><i>(Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi”; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane).</i></p> <p>Stafi akademik dhe studentët punojnë bashkë për projekte apo kërkim shkencor (në formën e detyrave të kursit dhe temave të diplomave), duke mundësuar dhe botimin e punimeve të tyre në organe botimi apo buletine. Studentët mbështeten nga institucioni për mundësimin e mobiliteteve, të cilat mbulohen financiarisht nga institucioni.</p> <p><i>(Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+; Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve; Evidenca 3.4 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit në dosjen për akreditim vërejmë se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit BGJSHL realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> <p>Përgjatë viteve akademike departamenti është angazhuar të ftojë pedagogë (brenda dhe jashtë Shqipërisë), të cilët kanë përparuar në fusha e disiplina të veçanta gjuhësore dhe studimeve letrare, kanë pasur sukses në përvetësimin e teorive moderne gjuhësore dhe studimeve në fushë të gjuhësisë bashkëkohore. Këto leksione dokumentohen në faqen e internetit të departamentit të gjuhësisë (facebook e instagram), si edhe në ëbsitin e UNIEL-it. Këto leksione të hapura pasqyrohen edhe në raportet e përvitshme analitike të veprimtarive të departamentit të gjuhësisë dhe të letërsisë dhe gazetarisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “BGJSHL” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2022; Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni realizon tërheqjen e stafit akademik me merita të vecanta në shërbim të realizimit të programit nëpërmjet organizmit të leksioneve të hapura, ëorkshopeve dhe aktiviteteve të larmishme kulturore dhe sociale, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	




Standardi III.5**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në referencë me dokumentacionin që gjendet në dosje konstatohet se departamentet e gjuhësisë (DGJ) dhe ai i letërsisë e gazetarisë (DLG) kanë hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e ka bërë atë publike. UE ka miratuar edhe formatin e punimit të diplomës dhe e ka publikuar atë.</p> <p><i>(Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dosjes për akreditim, DGJ dhe DLG, që mbulojnë programin e studimit Bachelor GJSHL, bashkë me stafin akademik përkatës, kanë ndërtuar dhe vënë në dispozicion të studentëve grup-pyetjet për provimin përfundimtar sipas fushave (gjuhësi dhe shkencë e letërsisë), në mënyrë që të informojnë e udhëzojnë studentët në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Pedagogët njohin studentët në fillim të vitit akademik me objektivat e tyre për kërkim shkencor, me qëllim që të shfrytëzohen si tema punimi. Çdo student përzgjedh pedagogun udhëheqës, në varësi të interesave që shfaq për të studiuar. Pedagogu dhe studenti bashkëpunojnë intensivisht përgjatë vitit akademik me takime, adresë elektronike, konsultime etj. Studentët pajisen me literaturën dhe materialet e nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor.</p> <p><i>(Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit); Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.38 Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar (gjuhësi)).</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Konstatohet se mbështetur në grup-pyetjet për provimin përfundimtar të hartuar nga departamentet përkatëse (DGJ dhe DLG), komisioni i posaçëm i ngritur nga drejtuesi i departamentit të gjuhësisë (kur studentët zgjedhin të japin provimin përfundimtar në gjuhësi) dhe i letërsisë dhe gazetarisë (kur studentët zgjedhin të japin provimin përfundimtar në letërsi) harton tezat dhe studentët përzgjedhin nga grupi i tezave të hartuara njëren prej tyre me vullnet të lirë.</p> <p>Komisioni i posaçëm, i ngritur me propozim të drejtuesit të departamentit dhe vendim të dekanit, për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët dhe modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.38 Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar (gjuhësi))</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>Konstatohet se udhëheqësi i temës së diplomës, në rastet kur studenti ka një mesatare të pranuar dhe ka zgjedhur të diplomohet me një temë diplomë, ka detyrim të orientojë dhe ndihmojë studentët në përcaktimin e temave të punimit, të cilat janë në fushën e kërkimit shkencor të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>specialitetit të pedagogut. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai duhet të garantojë cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes për akreditim, konstatohet se departamenti i gjuhësisë që mbulon ekspeditën gjuhësore, e cila zhvillohet në javën e fundit të planit mësimor 3-vjeçar për Bachelor GJSHL, asiston studentët jashtë mjediseve të institucionit në mbledhjen dhe evidentimin e pasurisë leksikore, frazeologjike apo folklorike, mbështetur kjo në tematikat dhe fushat e studimit që mbulon ky program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.37. Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dosjes na rezulton se mbrojtja e temës së diplomës dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar realizohet pranë komisionit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të cilët caktohen nga drejtuesi i departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Komisioni në përfundim të prezantimeve nga secili student, bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)).</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Dokumentacioni i dosjes sanksionon se në përfundim të studimeve, UE pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Procedurat ndiqen nga sekretaria mësimore pranë FSHH-së.</p> <p><i>(Evidenca 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 1.29 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit. Modeli i diplomës të programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.30 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi").</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti</p>	<p>Në referencë me dokumentacionin për akreditim, konstatohet se UNIEL ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin, nëse kërkohen. Dokumentacioni i studentit ruhet në bazë të</p>



informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të rregulloreve përkatëse nga sekretaria mësimore pranë FSHH-së. Informacionet për studentin ruhen edhe në sistemin EMS. Njësia kryesore krijon dosjen e studentit që në çastin e regjistrimit, dosje e cila pasurohet më tej me të dhëna në sistemin elektronik dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; 2.5. Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE "A. Xhuvani")</i> <i>(https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1312-rregullore-per-krijimin-regjistrimin-ruajtjen-sherbimin-dorezimin-e-dokumentave-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani, Evidenca 4.11 Rregullorja EMS)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Procedura për detyrimet përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe pajisja e tij me dokumentacionin përkatës është e qartë dhe transparente. Ajo zbatohet bazuar në rregulloren e UE, statutit dhe rregullores së FSHH.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në varësi të informacioneve që gjenden në dosje vërejmë se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, që mbulon programin e studimit BGJSHL përmbush standardet kualifikuese sipas kërkesave ligjore në fuqi. Në programin BGJSHL aktualisht japin mësim 14 pedagogë (6 të departamentit të gjuhësisë dhe 8 të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë), të cilët kanë titujt “Profesor i asociuar”, “Doktor” dhe “Asistent lektor”. Stafi akademik ka nivelin e duhur akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit.</p> <p>Personeli akademik mbulon në programin e studimit fushat kërkimore sipas specialitetit, që kanë ose përvojë praktike, e cila reflektohet në modulet që mbulojnë. Kjo bazë të dhënash administrohet nga departamenti i gjuhësisë, i letërsisë dhe gazetarisë, si dhe nga Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivës.</p> <p><i>(Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Tabela 4 - Ngarkesa totale e personelit akademik të programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” në një vit akademik; Tabelat 6 - Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Evidenca 4.18 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit “Bachelor në gjuhë dhe letërsi”; Tabela 7 - Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas të dhënave që gjenden në dosje, çdo pedagog i personelit akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore është e përcaktuar sipas gradës apo titullit shkencor, sipas fushës kërkimore që mbulojnë dhe pozicionit të punës, duke u shtrirë në të dy semestrat akademikë. Çdo fillim viti akademik pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit programet mësimore për modulet që do të mbulojnë. Ngarkesa mësimore rregullohet në mbështetje të Udhëzimit të MASR Nr.29, datë 10.09.2018, Nr.9268, dhe duke zbatuar rregullat e parashikuara në dokumentet ligjore të UE “A. Xhuvani”.</p> <p><i>(Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse; Tabelat 12 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Tabela 4 - Ngarkesa</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>totale e personelit akademik të programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” në një vit akademik; Evidenca 4.21 Plani i ngarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 të departamentit të gjuhësisë).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, në dosje pohohet se UE mbështet qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit përmes rregullave dhe udhëzimeve të qarta mbi mbrojtjen e personelit akademik.</p> <p>Çdo pedagog ka të nënshkruar kontratën individuale të punës dhe i sigurohet në mënyrë korrekte, të vazhdueshme dhe të pacënueshme mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Sipas të dhënave që jep Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe protokoll-arkivës, pedagogët realizojnë në fillim të vitit akademik plotësimin e rregullave që lidhen me dëshminë e shëndetit të plotë fizik. Institucioni përditëson çdo vit të dhënat e personelit akademik efektiv.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022; Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 4.24 Kopje e kontratës individuale të punës)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe vizitës në UE, vërejmë se ky institucion ndjek politika rekrutimi të hapura dhe transparente nëpërmjet konkursit publik. Kriteret e pranimit përcaktohen sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</p> <p><i>(Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL; Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmësakademik).</i></p> <p>Po kështu, procedurat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të pjesshme apo të plotë realizohen nga departamenti dhe administrohen dokumentet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe protokoll-arkivës. Njoftimi për vendin e lirë të punës shpallet publikisht, pasi njësi bazë ka bërë propozimin në dekanat dhe është miratuar nga titullari i institucionit. Njësi bazë propozon ofertat e punës sipas kërkesave specifike në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Pranë njësisë bazë ngrihet komisioni <i>ad-hoc</i>, i cili shqyrton dhe vlerëson dosjet e aplikantëve të dorëzuara pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe protokoll-arkivës. Vlerësimi i kandidatëve realizohet sipas kuadrit ligjor që ndjek departamenti dhe në përfundim të procesit, kandidati fitues nënshkruan kontratën individuale të punës me përfaqësuesin më të lartë të institucionit, Rektorin.</p> <p>Propozimi për rekrutimin e pedagogëve të jashtëm realizohet pas mbledhjes së zhvilluar në departament, ku përcaktohen ngarkesat mësimore të pedagogëve efektivë dhe nevojat që lindin për personel</p>

	<p>akademik të jashtëm, duke specifikuar disiplinat që mbeten të paplotësuara.</p> <p><i>(Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 4.22 Kriteret për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme (2021).</i></p> <p>Gjatë vitit akademik, njësia bazë realizon dhe vlerësimin e punës së pedagogëve, duke shfrytëzuar zhvillimin e pyetësorëve me studentët dhe formatet e vetëvlerësimit të pedagogëve.</p> <p><i>(Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në dosjen për akreditim gjenden referenca që pohojnë se UE siguron dhe garanton përfshirjen e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Në programin e studimit BGJSHL janë parashikuar laboratorë, të cilat realizohen prej stafit akademik të departamentit të gjuhësisë, i cili është aftësuar në përdorimin e programeve elektronike dhe aplikacioneve të korrekturës gjuhësore elektronike dhe kështu nuk kërkohet angazhim i personelit ndihmës akademik. Në ekspeditën që zhvillohet në kuadrin e praktikës profesionale pedagogët i shoqërojnë vetë studentët, duke i udhëzuar për mbledhjen e materialit, kontaktin me informatorin gjuhësor etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.37 Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi")</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Konstatohet se rektorati i UE-së (Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Standardeve dhe e Kurrikulave dhe protokoll-arkivës), si dhe departamentet përkatëse mbledhin, ruajnë dhe përditësojnë të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit BGJSHL. Të dhënat përfshijnë informacione për personelin akademik të përfshirë në program në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ruajtja e të dhënave të personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme organizohet duke mbajtur një dosje personale për secilin pedagog me të dhënat, të cilat përditësohen çdo vit në skedar elektronik dhe ruhen në njësinë bazë.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 2.5 Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE "A.Xhuvani"; Evidenca 4.23 Rregullore e UE-së për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UE).</i></p>

	<p>Çdo fundviti akademik pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit pasqyrat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik që mbyllet. Ky proces pune realizohet nëpërmjet stafit akademik, drejtuesit të departamentit dhe Drejtorisë së Standardeve dhe Kurrikulave.</p> <p><i>(Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi").</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dosjes, konstatohet se UE ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programe të ndryshme të studimit.</p> <p>Departamentet përgjegjëse angazhojnë pedagogët për udhëheqjen e punimeve të diplomës apo në veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit, duke respektuar dokumentet rregullore ligjore të departamenteve. Gjithashtu, ekspedita gjuhësore realizohet sipas programit të miratuar dhe buxhetit që në fillim të vitit akademik dhe pedagogët e këtij programi i mbikëqyrin vetë studentët në terren.</p> <p><i>(Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave; Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë; Evidenca 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 1.37. Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore)</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Konstatohet se në dokumentacioni që gjendet në dosje pohohet që për realizimin e praktikave profesionale (ekspeditës gjuhësore) është përcaktuar roli i pedagogut mbikëqyrës/shoqërore, i cili ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve – detyrën e kursit të praktikës, ose paketës së ekspeditës, si dhe realizon vlerësimin e studentëve për praktikën profesionale. Praktika, e cila realizohet në formën e ekspeditës gjuhësore ndihmon studentët për dijet gjuhësore të mësuara përgjatë 3 viteve të studimit në terrenin e kërkimit të faktit gjuhësor dhe vlerësohen për detyrën e kryer.</p> <p><i>(Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë; Evidenca 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.37. Rregullore e Ekspeditës Gjuhësore).</i></p>

Konkluzione	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Raporti i pedagoqeve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjeshme është në përputhje me nevojat aktuale të departamenteve. Bëhen vazhdimisht përpjekje serioze nga ana e stafit akademik për përmbushjen e kualifikimit të tyre shkencor sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjeshmë	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e bërë në UE pohojmë se njësitë bazë kanë në dispozicion për zhvillimin e programit mësimor BGJSHL, mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, në varësi të numrit të studentëve, grupeve, sipas natyrës së programit dhe moduleve që zhvillojnë. Sallat, auditorët, biblioteka, labororet janë të gjitha funksionale.</p> <p>(Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit), (Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratoreve të Fakultetit). (Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK; Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, labororë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita e bërë në UE konstatojmë se mjediset mësimore, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Labororët dhe mjediset e tjera garantojnë realizimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Klasat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, pa qenë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit të llojit kompjuter.</p> <p>(Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK; Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit; Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës).</p>
<p>Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për</p>	<p>Institucioni ofron kushtet dhe pajisjet e nevojshme të punës për të gjithë stafin në përputhje me rregulloret e brendshme dhe kuadrin ligjor, në mënyrë që personeli akademik të jetë efektiv në kryerjen dhe përmbushjen e detyrës në përputhje me rrethanat.</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<i>(Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK; Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit).</i>		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në UE dhe dokumentacioni pohojmë se njësitë bazë kanë në përdorim laboratorët e nevojshëm (informatikë, gjuhë e huaj, laborator studimi, bibliotekë) për realizimin e procesit mësimor sipas kriterëve që përcakton kuadri ligjor. <i>(Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve të Fakultetit).</i>		
Konkluzione	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë ka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. Vizita në terren konfirmoi të dhënat e paraqitura në raport. Laboratorët , biblioteka dhe mjediset mësimore janë të përshtatshme dhe në shërbim të studentit. Ka ende vend për përmirësim të ambienteve (klasave mësimore) për pajisje që i dedikohen procesit mësimor që të jenë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron një lidhje të qëndrueshme Eëfi, që të shfrytëzohet brenda klasave gjatë mësimin dhe që të ndihmojë zhvillimin interaktiv dhe atë në distancë të tij, por edhe në cilësinë e mësimdhënies.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron gjithashtu që ambientet e mësimdhënies të jenë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe monitorë, të cilat shërbejnë për një procesi mësimor cilësor.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Në bazë të sillabuseve që gjenden në dosje konstatojmë se pedagogët e programit BGJSHL përdorin dhe sugjerojnë literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve, e cila ofrohet në formë fizike dhe digjitale. Studentët kanë në dispozicion një fond të dedikuar të librave, në Bibliotekën e UNIEL. Studentët kanë mundësi të gjejnë literaturë në bibliotekën e universitetit, si dhe me anë të portalit të bibliotekës online JSTORE. Për mësimdhënien ka qenë në përdorim gjatë dy viteve të Pandemisë Covid-19 edhe platforma Microsoft Teams.</p> <p><i>(Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.8 Fondi i librit; Të dhëna për burimet e literaturës për programin e</i></p>

	<i>studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHH; Evidenca 3.21 Të dhënat për bibliotekën).</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Nga dokumentacioni që gjendet në dosje vërejmë se departamentet përgjegjëse i informojnë studentët e programit të studimit BGJSHL për përditësimin e literaturës së botuar në vitet e fundit nëpërmjet njoftimit verbal, bibliotekës, bibliotekës online, si dhe njoftimit në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 3.8 Fondi i librit (Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHH; Evidenca 3.19 Buxheti për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti; Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës (Analiza vjetore institucionale 2020-2021).</i></p>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Konstatohet se në funksion të studentëve është biblioteka e universitetit, e cila ofron shërbim edhe ditën e Shtunë.</p> <p>Biblioteka online është e aksesueshme përgjatë gjithë kohës, gjë që garanton mundësinë e shfrytëzimit nga ana e studentëve në mënyrë të barabartë. Institucioni ofron dhe bibliotekën online JSTOR dhe U-library.</p> <p><i>(Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL; Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; 3.8 Fondi i librit (Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHH))</i></p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	<p>Nga vizita në UE konstatohet se Biblioteka Universitare pranë korpusit qendror të UE-së zotëron mjedise fizike cilësore dhe është e pajisur me fond librash e tekstesh, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e moduleve e veprimtarive mësimore, që ofron programi i studimit BGJSH. Në bibliotekë ka një fond të pasur librash për albanologjinë, të cilat janë siguruar nga bashkëpunimet e njësisë bazë me institucione apo individë të tjerë.</p> <p>Në Bibliotekën e UE-së ka një fond unik librash të albanologjisë, dhuratë e albanologut frëng, Christian Gutt në dispozicion të stafit të departamentit dhe studentëve të BGJSHL.</p> <p><i>(Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; 3.8 Fondi i librit (Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHH))</i></p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>Konstatohet se biblioteka online JSTORE nuk ka tarifa për studentët e programit të studimit BGJSHL dhe çdo student mund të aksesojë për gjetjen e materialeve të nevojshme dhe në nivel ndërkombëtar. Institucioni mundëson listën e teksteve/ periodikëve në bibliotekë (hardcopy/ e-book dhe të shtuara në vitet e fundit) në funksion të programit të studimit (fondi i Gut-it).</p> <p><i>(Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; 3.8 Fondi i librit (Të dhëna për burimet e literaturës për programin e studimit që ofrohen nga Biblioteka e FSHH))</i></p>


<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita që bëme në UE vërejmë se biblioteka është e pajisur me pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Punonjësit e bibliotekës sigurojnë asistencën e nevojshme për plotësimin e kërkesave të studentëve të BGJSHL për literaturë.</p> <p><i>(Evidenca 3.21 Të dhënat për bibliotekën; Evidenca 4.9 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIELEvidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL).</i></p>		
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në UE pohojmë se Biblioteka Universitare pranë korpusit qendror të UE-së është në dispozicion të studentëve me orar të zgjatur, i cili është në përshtatje me zhvillimin e procesit mësimor, duke iu përgjigjur nevojave të studentëve edhe gjatë fundjavës.</p> <p><i>(Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL; Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit; Tabela 17 - Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online etj.).</i></p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit pohojmë se DGJ dhe DLG komunikojnë me Bibliotekën e Universitetit dhe informohen çdo vit për fondin e librave më të cilat pasurohet në vijim. Produktet kërkimore dhe shkencore të pedagogëve, temat e disertacioneve të studentëve, si dhe produktet e konferencave apo veprimtarive të tjera shkencore të organizuara nga njësia bazë, i dërgohen Bibliotekës së universitetit, të qytetit dhe Bibliotekës Kombëtare.</p> <p>Njësia bazë mbledh nevojat e pedagogëve dhe studentëve për fondin e nevojshëm të librave dhe ia komunikon bibliotekës së universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Evidenca 3.8 Fondi i librit (për programet e studimit që ofron nga departamenti i gjuhësisë).</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në mbështetje të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka mjediset mbështetëse të mjaftueshme për realizim cilësor të programit të studimit. Nga vizita në UE konstatojmë se Biblioteka Universitare pranë korpusit qendror të UE-së zotëron mjedise fizike cilësore dhe është e pajisur me fond librash e tekstesh, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e moduleve e veprimtarive mësimore, që ofron programi i studimit BGJSH. Në bibliotekë ka një fond të pasur librash për albanologjinë, të cilat janë siguruar nga bashkëpunimet e njësisë bazë me institucione apo individë të tjerë. Biblioteka është në dispozicion të studentëve sipas orarit 08:00-17:00, çdo ditë nga e Hëna në të Premte dhe ditën e Shtunë 08:00-16:00.</i></p> <p><i>Institucioni është i anëtarësuar në JSTORE dhe U-Library.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit na rezulton se UE disponon sistemin elektronik të të dhënave EMS, ëëë.uniel.ems.al, si dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studentëve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit zyrtare (me @uniel.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional, por edhe të jashtëm.</p> <p>EMS është sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave të studentëve, ku administrohet i gjithë informacioni, nga fillimi e deri në përfundim të studimeve. Njësia kryesore, dekanati i FSHH-së, disponon informacionin që lidhet me studentët dhe mbi aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomimin e programit të studimit. Të dhënat ruhen në dokumentacionin e sekretarisë mësimore pranë FSHH-së.</p> <p><i>(Evidencat: 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës-akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Konstatohet se sistemet e brendshme të menaxhimit EMS dhe adresat zyrtare të emailit (me @uniel.edu.al) administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 4.11 Rregullorja EMS)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se sistemi i menaxhimit i krijon akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për personelin dhe studentët, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemi EMS u jep mundësi pedagogëve të ngarkojnë në sistem materiale ndihmëse për studentët. Përgjatë periudhës së Pandemisë Covid-19 i gjithë sistemi i mësimdhënies akademike u realizua me Microsoft Teams, i cili mund të përdoret ende më tej për dhënien e materialeve teorike (literaturë, leksione për studentët, video etj.)</p> <p><i>(Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB; Rregullore e UE-së për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UE; shih evidencat: 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams).</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, konstatohet se Sistemi EMS ka të përfshira në kapacitetet e veta komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve të tjera, por këto nuk janë ende të aktivizuara.</p> <p>Sistemi i menaxhimit mundëson regjistrimin e lëndëve të studentit, i cili ndjek aktivitetin akademik të lëndëve përgjatë semestrit dhe gjenden të dhëna që i nevojiten: orarin mësimor, vlerësimet, tarifat e studimit etj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>Sistemi i ofruar përmes platformës Moodle uniel.edu.al dhe platforma MS Teams realizon komunikimin interaktiv: personel akademik e studentë.</p> <p><i>(Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Konstatohet se sistemi i EMS i menaxhimit është lehtësues në raportimet e të dhënave në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese, përmes llogarive personale të stafit akademik, të cilët kanë akses sipas rolit të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 4.11 Rregullorja EMS)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Vërejmë se faqja zyrtare e universitetit (ëëë.uniel.edu.al) përmban informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet, të cilat përditësohen vazhdimisht dhe janë të shkruajtura në gjuhën shqipe.</p> <p><i>(Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE disponon sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Konstatohet se sistemet e brendshme të menaxhimit EMS dhe adresat zyrtare të emailit (me @uniel.edu.al) administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative.</i></p> <p><i>Informacioni gjendet në dy gjuhë; Shqip dhe Anglisht, por informacioni në gjuhën angleze nuk është i plotë (shembull- programet mësimore).</i></p> <p>Nisur nga sa më sipër GVJ rekomandon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UE-s në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj • Përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p><i>Përmbushet pjesërisht</i></p>	<p><i>Përmbushet kryesisht</i></p>	<p><i>Përmbushet plotësisht</i></p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të</p>	<p>Nga dokumentacioni shqyrtuar, konstatohet se Universiteti i Elbasanit ka hartuar raportin financiar të kostove të programit të studimit dhe ofron planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit BGJSHL.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al





E-mail: info@ascal.al

<p>studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Për hartimin e këtij raporti financiar kujdeset Drejtoria Ekonomike, e cila ua vë në dispozicion departamenteve përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi).</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar pohon se buxheti i UNIEL miratohet nga Bordi i Administrimit dhe shpërndahet për zbatim në të gjitha njësitë bazë. Fondet janë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit, të cilat shpërndahen sipas nevojave që paraqesin njësitë bazë për plotësimin e kërkesave të planifikuara. Çdo Qershor, DGJ dhe DLG paraqesin kërkesat për nevoja në materiale në shërbim të realizimit të programeve, si dhe për mbështetje në kërkimin shkencor, duke pasqyruar parashikimet financiare të nevojshme për vitin akademik.</p> <p><i>(Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022; Evidenca 4.15 Miratimi i regjistrimit të prokurimeve dhe shërbimeve; Evidenca 4.17 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit aktual (2020 dhe 2022), departamenti i gjuhësisë; Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas dosjes për akreditim, UE i nënshtrohet vazhdimisht auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacionet e transaksioneve ekonomike e financiare.</p> <p>UE analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, nëpërmjet rishikimit periodik të buxhetit dhe rialokimit të fondeve sa herë lind nevoja.</p> <p><i>(Evidenca 4.13 Raporti i auditit KLSH 2022; Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, DGJ dhe DLG njihen me raportin financiar të institucionit, i cili i bëhet me dije dhe anëtarëve të njësisë bazë, njëkohësisht është i aksesueshëm dhe në faqen zyrtare.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se UE garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të departamentit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të programeve të studimit që realizon.</p> <p>DGJ dhe DLG punojnë për të garantuar qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin dhe ecurinë e BGJSHL. Pedagogët marrin pjesë në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e situatës financiare të njësisë bazë.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi).</i></p>

Konkluzione	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p> <p><i>Cdo vit akademik, departamentet hartojnë projekt-buxhetin e tyre duke përfshirë kërkesat e tyre financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit, i cili përfshihet në projekt buxhetin e fakultetit. Buxheti i kërkuar miratohet në BA dhe vihet në dispozicion të departamentit dhe fakultetit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Dokumentacioni pohon se UE pranon në programet e studimit studentë sipas kuotave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse. Studenti duhet të plotësojë kriteret e regjistrimit sipas procedurës përkatëse. Procedurat e regjistrimit kryhen sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore.</p> <p>FSHH i pajis studentët me të gjitha materialet e nevojshme informuese si broshura, i adreson në faqen ueb dhe i informon në lidhje me çdo mjet tjetër komunikimi. Rregullorja e studimeve në UE, e FSHH-së dhe e departamenteve përkatëse përcakton mënyrën dhe kohën se kur studenti e fiton statusin e tij dhe kur e humbet atë. Qysh nga koha kur studenti e ka fituar statusin e tij e deri në përfundim të studimeve të tij në BGJSHL, studenti ndiqet dhe mund të pajisjet me çdo informacion të nevojshëm jo vetëm në departament por edhe në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi")</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, pohojmë se aplikimi i studentëve për pranimin në programet e studimit i jep barazi të gjithëve, për shkak të sistemit elektronik që përdoret. Pranë sekretarisë kryhet regjistrimi dhe studentët regjistrohen në sistemin EMS, ku ndiqet vijimësia e tyre deri në diplomim.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, konstatojmë se në fillim të çdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve, sipas afateve kohore të përcaktuara në VKM. QSHA dhe RASH janë institucionet përgjegjëse që përgjigjen për pranimin në programet e studimit dhe transferimet. Universiteti pasqyron kriteret e pranimit për çdo program studimi dhe këto pasqyrohen në faqen ueb të universitetit dhe në u-Albania.</p> <p>Faqja zyrtare e universitetit u jep mundësi studentëve të marrin kontakte për pyetje apo paqartësi të ndryshme.</p> <p><i>(Evidenca 1.30 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Tabela 25 – Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit)</i></p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Dokumentacioni i dosjes pohon se UE ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve. Informacioni është i aksesueshëm nga këto burime: sekretaria mësimore, faqja zyrtare (sistemi EMS) dhe QSHA, që japin informacione për çështje të ndryshme: procedurat e pranimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit e diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni bashkangjitur, konstatohet se UE "A. Xhuvani" informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit, përmes portalit U-albania dhe faqes zyrtare të universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen; Evidenca 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se UE ka të programuar politika mbështetëse për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara, duke informuar nëpërmjet faqes zyrtare dhe sekretarisë mësimore mundësitë e pranimit në universitet nga këto kategori dhe bonuset që përfitojnë.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Konstatohet se UE "A. Xhuvani" informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të veçanta.</p> <p><i>(Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL; Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Konstatohet se UE "A. Xhuvani" zbaton politika mbështetëse për individët me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke i përjashtuar nga tarifat e studimit, dhënies së bursave sipas kategorive të caktuara dhe veprimtarive të ndryshme sociale në ndihmë të këtyre kategorive.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Gjithsesi, vlen të përmendet numri i vogël i aplikimeve në këtë program studimi.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			x

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit bashkangjitur, konstatohet se UE "A. Xhuvani" ka miratuar Rregulloren e Studimeve institucionale dhe secila njësi kryesore ka të miratuar Rregulloren e Studimeve përkatëse. Këto rregullore janë të publikuara në faqen eeb dhe studentët kanë akses në çdo kohë.</p> <p>FSHH vë në dispozicion sekretarinë mësimore, sistemin EMS dhe njësinë bazë për të marrë informacion në lidhje me procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Tabela 25 – Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Konstatohet se sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Standardeve dhe e Kurrikulës informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në varësi të dokumentacionit bashkangjitur, pohohet se DGJ dhe DLG dhe çdo pedagog që jep mësim në BGJSHL, bazuar në Rregulloren e studimeve të UE-së dhe të FSHH-së, si dhe në Rregulloren e DGJ dhe DLG jep informacion për studentët lidhur me vlerësimin e tyre për lëndët që ata japin në këtë program studimi, duke i paraqitur silabusin e lëndës/modulit përkatës.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi").</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumentacioni bashkangjitur pohon se UE "A. Xhuvani" ka hartuar rregulloren e studimeve, ku informohen studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe të diplomimit. Gjithashtu, ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës dhe e ka publikuar atë. Ky material gjendet dhe në faqen zyrtare të universitetit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>Informimi i studentëve në lidhje me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit realizohet nga struktura e departamentit, i cili ka të hartuar edhe rregulloren e diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Shqyrtimi i dosjen na lejon të konstatojmë se institucioni ka strukturë të dedikuar (zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë.</p> <p>UE ka publikuar një spot promovues për programet e studimit që ofron dhe fletëpalosje promovuese, një prej tyre e hartuar edhe nga departamenti i gjuhësisë, me programet që ofron, në të tria ciklet e studimit.</p> <p><i>(Evidenca 5.3 Publikimi i spotit promovues; evidenca 5.4 Fletëpalosjet promovuese institucionale (edhe të departamentit të gjuhësisë); Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës).</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga bisedat me studentët u konfirmua se niveli i ofrimit të shërbimeve dhe dokumentacioni që marrin nga sekretariatë mësimore është i plotë. Studentët kishin informacion lidhur me format e kontrollit të dijeve si testimet ndërmjetëse, detyrat e kursit, ushtrimet në laborator, praktika profesionale apo provimet e formimit. Lidhur me këto detaje studentët informohen kryesisht nga pedagogët në orën e parë të modulit, por informacioni është gjithashtu i përhershëm në faqen eeb të universitetit (ëëë.uniel.edu.al).</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Në varësi të dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se DGJ dhe DLG, sekretaria mësimore dhe sistemi EMS dhe koordinatori i programit të studimit i ofrojnë studentit informacione të rëndësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "BGJSHL"; Evidenca 1.25 Përshkrimi i detyrave të koordinorit të programit të studimit; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi")</i></p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Dokumentacioni bashkangjitur na lejon të konstatojmë se UE vë në dispozicion të studentëve informacionet për përbajtjen e programit të studimit BGJSHL. Studenti i akseson të dhënat edhe nëpërmjet profilit dhe llogarisë që ka në EMS. Gjithashtu informacioni gjendet i publikuar në faqen ueb të institucionit, sipas zërave përkatës. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore. Po ashtu, plani mësimor i programit të studimit afishohet pranë mjediseve të FSHH-së dhe është i disponueshëm për çdo ditë të vitit akademik të BGJSHL-së.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit ka si detyrë funksionale të tij gjithashtu të mbajë lidhje të qëndrueshme me studentët dhe t'u japë informacione lidhur me planet mësimore dhe programet e lëndëve dhe moduleve si dhe veprimtaritë formuese.</p> <p><i>(1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 1.25 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Dokumentacioni që gjendet në dosje na pohon se zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale.</p> <p><i>(Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës; Evidenca 5.5 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në varësi të informacionit që jepet në dosje dhe vizitës në UE, konstatojmë se vendos në dispozicion të studentëve salla, laboratorë si dhe gjithë shërbimet që i marrin edhe në mënyrë elektronike. Studentët e programit të studimit BGJSHL marrin informacion të plotë mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Orari mësimor i BGJSHL, ku janë të pasqyruara orët, klasat, pedagogët përgjegjës, afishohet nga sekretaria mësimore e FSHH-së përpara se të fillojë viti akademik. Ai gjithashtu u jepet në formë elektronike studentëve nga drejtuesi i departamentit ose koordinatori i programit.</p> <p><i>(Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK; Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit); Evidenca 1.25 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se studentët marrin informacion nëpërmjet sistemit EMS, i cili është i arritshëm dhe në distancë në 24 orë. Kontaktet e vendosura në sistemin EMS krijojnë hapësirë për të marrë përgjigje për çdo paqartësi.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjithashtu informacioni gjendet i publikuar në faqen ËEB të institucionit, sipas zërave përkatës. <i>(Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB).</i>		
Konkluzione	<p>Në cdo fillim viti akademik dhe perodikisht, UE organizon takime të hapura për informimin e studentëve të interesuar për programet e studimit.</p> <p>Organizohet "Java e orientimit" ku vecanërisht studentët e rinj njihen me stafin, ambientet dhe detyrimet e tyre, takime për këshillim karriere, fushatë informuese për maturantët, panairë pune, komunikime mediatike.</p> <p>Nga biseda me studentët GVJ konfirmon kordinatorin e studentit, i cili realizon funksionin e tij sipas rregullores e programit.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Konstatohet, në bazë të dokumentacionit bashkangjitur, se njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, si dhe Sekretaria Mësimore pranë FSHH-së disponon dhe mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit BGJSHL.</p> <p><i>(Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Tabela 25 – Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit).</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Të dhënat në dosje pohojnë se sekretaria Mësimore pranë FSHH-së mban dosjen personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në institucion. Kjo dosje përditësohet edhe me elemente të tjera, si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, vlerësimi i tezës së diplomimit, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p><i>(Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Tabela 25 – Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit).</i></p>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të	<p>Dosja dhe të dhënat në të na bëjnë të konstatohet se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse: Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Ato</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423





Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



<p>sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, sistemin EMS, departament, si dhe të informacione në dekanat, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se rektorati dhe drejtoritë përkatëse që lidhen me organizimin e punës në universitet kryejnë kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve për menaxhimin e informacioneve dhe dokumentacioneve (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.), ku vlerësohet dhe dokumentohet gjendja dhe saktësia e informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 2.5 Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE "A. Xhuvani").</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes, vërejmë se DGJ dhe DLG marrin informacion të plotë nga sekretaria mësimore e FSHH-së lidhur me cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje të studentëve për programin e studimit BGJSHL, si dhe cilësinë e punësimit të tyre dhe harton raportin vjetor të analizës së punës mësimore dhe shkencore, ku raportohet për cilësinë e studentëve në provime, numrin e të diplomuarve dhe cilësisë së punësimit të tyre, duke u përqendruar në vlerësimet e marra përgjatë viteve të studimit, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, që e siguron nëpërmjet Zyrës së ALUMNI-t, i cili realizon gjurmimin e studentëve. Të dhënat e mbledhura janë të vlefshme për hartimin e politikave të njësive bazë mbi përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p>Nga takimi me studentët u konfirmua fakti se një pjesë e tyre për arsye punësimi gjatë kohës së studimit, preferojnë kryeqytetin. Afërsia gjeografike mundëson largimin e tyre në qytetin e Tiranës, ku ata mund të studiojnë dhe punojnë njëkohësisht.</p> <p><i>(Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi"; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim. Institucioni disponon një listë punësimi të studentëve të diplomuar, por prej saj nuk është e qartë se cilës periudhë diplomimi i takojnë. Gjurmimi nuk është</i></p>


	<p>periodik, si rrjedhojë tabela e të dhënave dhe cilësisë së punësimit nuk është e plotë.</p> <p>Për rrjedhojë, GVJ rekomandon përmirësimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me punësimin e të diplomuarve të këtij programi specifik studimi.</p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregulatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në UE, pohojmë se studentët e UE-së përfaqësohen sot në organe në nivel institucional dhe në organe në nivel njësie kryesore në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Senatin Akademik -Këshillin Studentor -Komisionin e Përhershëm për Standardet e Cilësisë -Komisionin e Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës <p>Senati akademik i UE-sëka në përbërje dy studentë senatorë, të cilët zgjidhen nga vetë studentët, komisionet e përhershme kanë nga 1 student të zgjedhur nga vetë studentët. Studentët janë organizuar edhe në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre.</p> <p><i>(Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në UE, konstatojmë se përfshirja e studentëve senatorë të Senatit Akademik në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim mbi procesin akademik ka si qëllim shprehjen e mendimeve dhe propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm si për programet e studimeve, planet mësimore etj.</p> <p>Mendimi merret drejtpërdrejt nga takimet e studentëve ose nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve.</p> <p><i>(Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Evidenca 5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor; Evidenca 5.8 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional; Evidenca 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet; Evidenca 5.11 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi"; Evidenca 5.17 Rregullore për</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



	<i>funkcionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës).</i>		
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Sipas dokumentacionit të dosjes, koordinatori i programit të studimit BGJSHL komunikon me studentët lidhur me problematikat që ata mund të kenë për ngarkesën mësimore si dhe përparimin e studentëve. Koordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës së programit dhe merr sugjerime për përmirësimin e tij, përmes mbledhjeve të përbashkëta me studentë në vijim, por edhe të diplomuar, dhe duke propozuar hartimin e pyetësorëve për ish-studentët tashmë të punësuar.</p> <p><i>(Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” në 3 vite)</i></p>		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Sipas dokumenteve bashkangjitur, pohojmë se në rastet kur studentët janë të pakënaqur më rezultatet e vlerësimit, ai paraqet një ankesë pranë drejtuesit të njësisë bazë, sipas lëndës ku studenti ka ka vërejtje (nëse është pedagog i departamentit të gjuhësisë te drejtuesi i departamentit të gjuhësisë). Ky i fundit ngre një komision rivlerësimi (i cili nuk është i njëjtë me komisionin e parë), i cili rishqyrton dokumentacionin e provimit në mënyrë transparente.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë)</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe se në dispozicion të tyre ka informacion të mjaftueshëm lidhur me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</i></p> <p><i>Funksionimi i kërkesave të këtyre rregulloreve u konfirmua nga takimi me një grup studentësh të programit të studimit. Ndërkohë, planet mësimore u pa të ishin të afishuara në ambientet e UE-s dhe po ashtu, mund të shkarkoheshin në cdo kohë në faqen ëeb të universitetit.</i></p> <p><i>Studentëve u është shpërndarë informacioni i plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet orarit mësimor. Studentët informohen për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor përmes sekretarive përkatëse. Ky informacion u konfirmua nga studentët gjatë takimit që pati GVJ. Nga takimet me studentët , GVJ konstatoi se ata ishin të përfshirë në përfaqësitë e tyre në nivel fakulteti. Konkretisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisionin e sigurimit të cilësisë • Komisionet e përhershme <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të konsultuar, vërejmë se UE ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve. Këto struktura janë institucionale (sekretaritë, zyra e IT, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Institucioni vë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë. Drejtoria e Këshillimit dhe Karrierës dhe ALUMNI ka në funksionin e saj informimin e studentëve si dhe shërbime të tjera që mund të ofrohen për studentët si asistenca, këshillimi etj.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; evidenca 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas rregulloreve bashkangjitur, konstatojmë se Drejtoria e Këshillimit, Karrierës dhe ALUMNI funksionon pranë UE. Kjo drejtori në mënyrë të posaçme ka si detyrë funksionale informimin, këshillimin, dhe ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre edhe për tregun e punës. Gjithashtu, në UE funksionon Drejtoria e Standardeve dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka si detyrë dhënien e ekspertizës për përmirësimin e procesit mësimor dhe për programet e studimit. Kjo drejtori ofron ekspertizë si për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sipas evidencës së bashkangjitur, konstatojmë se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI është krijuar sipas përcaktimeve në Statutin e UE-së. Komisioni i përhershëm institucional është krijuar dhe funksionon në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës si dhe Komisioni në nivel njësie kryesore për mbrojtjen e studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës; Evidenca 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A.Xhuvani").</i></p> <p>Nga diskutimet me përfaqësuesit e Zyres së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI u vu në dukje se një prej arsyeve të forta që studentët nuk preferojnë programin e GJ-L, është konkurrenca e konsiderueshme nga programe të tjera studimi, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë Universiteti i Elbasanit.</p> <p>Qendra për Këshillimin Studentor pranë korpusit qendror ofron informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me përmbushjen dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>realizimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p><i>(Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit bashkangjitur, vërejmë se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon procesin e gjurmimit të studentit pas diplomimit, përpunon dhe mban të dhëna për punësimin e studentëve, me qëllim që të shërbejnë si informacion për studentët dhe autoritetet drejtuese të institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Evidenca 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani").</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE ka hartuar një sërë dokumentesh që mundësojnë sigurimin e barazisë, vlerësimit dhe kontrollit, si regjistri fizik, pasqyra e vlerësimit të studentit, hedhja e të dhënave për vlerësimin e studentit në sistemin e-student , ku student para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit.</i></p> <p><i>Pas periudhës së parashikuar në rregullore, nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që në rastet e anikimimit, procedura, si dhe vendimi i marrë të regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në Departament ose në Dekanat.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që raportin vjetor të aktivitetit akademik, të cilin UE e paraqet pranë MASR dhe e publikon, t'ua bëjë të ditur edhe studentëve, me qëllim përfshirjen e tyre në analizë.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës së kryer në UE, konstatohet se institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë.</p> <p>UE ka ngritur sektorin e Sigurimit të Cilësisë pranë Drejtorisë së Standareve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe ka hartuar rregulloren e kësaj strukture, e cila ka në përmbajtje përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>Mirëfilli nuk ka një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>UE kualifikon stafin akademik në fushën e kërkimit, duke e konsideruar këtë si prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner.</p> <p>UNIEL ka hartuar edhe një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë.</p> <p><i>(Shih Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve; 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Konstatohet se në institucion është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Njësia bazë zhvillon në mënyrë periodike monitorimin e aftësive të mësimdhënies të personelit akademik dhe ndihmësakademik nëpërmjet rishikimit të kurrikulës në programet e studimit.</p> <p>Propozimet përcillen në dekanat dhe më tej shqyrtohen nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë në institucion dhe Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë në FSHH.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në fakultet; Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Sipas dokumentacionit, pohojmë se institucioni ka si strukturë Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili zhvillon pyetësin e studentëve për matjen e performancës. Në fund të çdo viti akademik përpilohet raporti mbi rezultatet e pyetësit studentor mbi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>vlërësimin e Cilësisë së Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi dhe të dhënat janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Në Komisionin e Përhershëm për Standardet e Cilësisë, një anëtar është përfaqësues i studentëve. Gjithashtu, Universiteti i Elbasanit garanton të drejtën për t'u ankuar, e drejtë kjo e përfshirë si nen në Rregulloren e studimeve të UE-së dhe Rregulloren e studimeve të FSHH-së dhe të departamenteve.</p> <p><i>(Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL; Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga të dhënat në dosje, pohojmë se në përmbyllje të çdo viti akademik, hartohet një raport nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, i cili publikohet në faqen zyrtare të UNIEL-it. Ky raport realizohet në zbatim të politikave të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë. Raporti ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar problematikat, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Studentët, si fokusi kryesor i Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me vlerësimin e tyre mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Ky kontribut është burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve institucionale dhe akademike që ofron UE.</p> <p><i>(Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.19 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL; Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas evidencave bashkangjitur, konstatohet se UE vlerëson rezultatet e marra nga pyetësorët vlerësues të procesit të mësimdhënies nga studentët, nga raporti i analizës vjetore për fakultetin dhe universitetin etj., të cilat publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it.</p> <p><i>(Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021).</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	<p>Në dijeninë tonë, nuk ka ndodhur promovimi i shembujve të mirë dhe nxitja e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Dhe në raportin e fundit të pyetësorit të studentëve nuk ka rrokje të problematikave reale që lidhen me procesin e mësimdhënies në MSHGJ.</p> <p><i>[Shih Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022]</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Raportet e vlerësimit përfshijnë gjithë personelin akademik ndihmës akademik dhe administrativ.</i></p> <p><i>Vlerësimi kryhet nga studentët një herë gjatë vitit akademik dhe nëpërmjet pyetësorit merret informacion i përditsuar për ecurinë e procesit mësimor, shkallës së cilësisë së mësimdhënies, kontekstit lëndor, duke krijuar hapësirë e mundshme për përmirësimin e procesit mësimor në hallkat e tij përbërëse.</i></p> <p><i>Bazuar në raportin përmbledhës të pyetësorit studentor të konfirmuar edhe nga biseda me GVB 50% e numrit të studentëve që kanë marrë pjesë në pyetësor.</i></p> <p><i>Departamenti realizon pyetësorin e tij sa herë që përfundon procesi i lëndës përkatëse. Detajet dhe procedurat paracaktohen nga përgjegjësi i departamentit. GVJ gjykon se kjo pjesëmarrja e studentëve në këtë anketim e bën pak të besueshëm gjykimin e punës në tërësinë e saj. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Konstatohet se në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore të arsimit të lartë, njësia kryesore harton politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të përcaktuara në rregulloren dhe përshkrimin e punës të Njësisë së Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Struktura siguron promovimin e kulturës së cilësisë nëpërmjet një vargu të mekanizmave për komunikim.</p> <p><i>(Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani").</i></p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022).</i></p> <p>Gjithashtu, mbështetet dhe ofron ekspertizë për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënës, nëpërmjet realizimit të pyetësorëve që zhvillohen dy herë në vit sipas urdhrave të posaçëm.</p> <p><i>(Evidenca 5.13 Vendim i FSHH-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti</i></p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p><i>i gjuhësisë; Evidenca 6.3 Urdhrat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022).</i></p> <p>Në referencë me evidencën bashkangjitur, vërejmë se UE për Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë operon vetëm me një strukturë të posaçme, e ngritur pranë rektoratit, për të bërë funksional e për të garantuar zbatimin e strategjisë zhvillimore institucionale në planin afatgjatë.</p> <p>UE "A. Xhuvani" zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p><i>(Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se institucioni i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë. Në vlerësimin e fundit, akreditimi i tij ka qenë maksimal me 6 vite.</p> <p><i>(Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional).</i></p> <p>DGJ dhe DLG përdorin instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm, vlerësimeve analitike (analiza mësimore) dhe procedurat për përmirësimin e kurrikulave të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimeve BGJSHL nuk i është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme. Dhe ky raport i hartuar në vitin 2022 po i shërben këtij procesi.</p> <p><i>(Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" në 3 vite)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe të dhënave të tjera në dosje, vërejmë se në zbatim të akteve rregullatore, UE përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, të cilat kontrollohen nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>DGJ përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, duke listuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> -pyetësorin e vlerësimit nga studentët; -pyetësorin e vetëvlerësimit të pedagogëve; -pyetësorin e realizuar nga zyra e ALUMNI. <p><i>(Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik)</i></p> <p>Të dhënat sasiore dhe cilësore të mblledhura nga pyetësorët shërbejnë për të hartuar raportin vjetor për veprimtarinë e programit të studimit, raportin vjetor të koordinatorit të programit dhe analizën vjetore të departamentit.</p>

	<i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021).</i>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të ngarkuar rezulton se institucioni përdor procedura të dokumentuara për shqyrtimin dhe miratimin e programeve të studimit, si dhe për mbikqyrjen e here pas hershme të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Instrumetat e përdorur për vlerësimin e cilësisë janë përmendur dhe më sipër. Ato përfshijnë anketimet dhe pyetësorët e studentëve në përfundim të çdo semestri për programin e studimit, për performancën e stafit akademik, etj.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sipas raportimeve në dosje, konstatojmë se programi i studimeve BGJSHL nuk i është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme. Dhe ky raport i hartuar në vitin 2022 po i shërben këtij procesi. Nga ana tjetër, DGJ dhe DLG dokumenton proceset për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit, që lidhen me akreditimin e tij, si: propozimet e departamentit për përmirësimin e kurrikulës, strategjitë dhe politika mbi përmirësimin e programit të studimit, plotësimi i pyetësorëve për vlerësimin e performancës së pedagogut, plotësimi i pyetësorëve për vetëvlerësimin e pedagogëve, analizë e punës mësimore, raporte vjetore, mbledhja e të dhënave për veprimtarinë shkencore që zhvillojnë pedagogët.</p> <p><i>(Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë; Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Evidenca 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe në letërsi"; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit "Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi" në 3 vite)</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e</p>	<p>Sipas evidencave bashkangjitur, pohojmë se në përmbyllje të vitit akademik DGJ dhe DLG, si edhe departamentet përbërës të FSHH-së diskutojnë dhe përcjellin në Dekanatine FSHH-së analizën vjetore.</p> <p><i>(Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.34 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021).</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafu», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



<p>arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Mbi këto analiza, dekanati përgatit analizën vjetore të fakultetit duke ia dërguar Senatit të UE-së. Përmbledhja e këtyre problematikave në analizën vjetore të FSHH-së dhe komunikimi i këtij informacioni në Senatin e UE krijon një mundësi të mirë për të krijuar të gjithë kushtet për ndryshimet e nevojshme dhe garantimin e rritjes së cilësisë së programit të studimit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Konstatohet se UE nëpërmjet strukturave të ngritura si: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e marrëdhënieve me jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe strukturave të tjera të posaçme në fakultete e departamente organizojnë punën, ndjekin dhe kontrollojnë procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore e programet në zbatimin e tyre.</p> <p>DGJ dhe DLG përdorin metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, si: vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit për vlerësimin e performancës, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve dhe ushtrimeve, testime të standardizuara nëpërmjet anëtarëve të komisionit në provime, leksione të hapura etj., çka garanton mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës; Evidenca 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” (në 3 vite).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Sipas të dhënave në dosje, mund të themi që Fakulteti i Shkencave Humane, DGJ dhe DLG për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta, si: sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; dhe metoda të drejtpërdrejta: si intervista, dëgjime në auditor, testime paraprake dhe përfundimtare, provime për modulet dhe vlerësime të detyrave të kryera nga studentët.</p> <p>Departamenti i Gjuhësisë me qëllim vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe të studentëve, zhvillon anketime/pyetësorë me studentët, duke ruajtur anonimat. Të dhëna të tilla, duke përfshirë edhe kalueshmërinë e studentëve, ciësinë e mësimdhënies, e pedagogut, silabuset dhe literatura etj., drejtuesi i DGJ ia përcjell përmes Dekanit të FSHH-së Rektoratit të UE-së. Rezultatet e tij bëhen të njohura dhe shërbejnë si një bazë orientuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit si dhe për rritjen e bashkëpunimit pedagog-student.</p> <p><i>(Evidenca 1.33 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	<p><i>Vlerësimi institucional i realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit dominohet nga metodat të drejtpërdrejta të vlerësimit. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi dhe përmirësimi periodik i kurrikulës, analiza e procesit të mësimdhënies dhe e rezultateve të studentëve, apo analiza periodike e efektivitetit të praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve janë objekte të përhershme të analizave vjetore të departamentit përgjegjës për programin mësimor dhe vetë njësisë kryesore, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. Vlerësimet paralele ekzistojnë gjithashtu si praktikë, por ato janë parashikuar dhe ndodhin në rastet kur studentët kanë reklamim për vlerësimin e kryer nga pedagogu përkatës. Institucioni ka bërë përpjekje për vlerësimin e cilësisë dhe ecurisë së programit edhe nëpërmjet metodave të tërthorta, ku thelbësor është anketimi periodik i studentëve. Vërejmë se nuk është i dokumentuar tërheqja e mendimit të institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. Në takimin me studentët u informuam se ata ishin në dijeni dhe pjesëmarrës së pyetësorëve të hartuara. Departamenti kryen analizën me Qendrën e Karrierës dhe Aluminit në cilën identifikohet edhe numri i të punësuarve nga ky program studimi, mundësitë e promovimit të këtij programi. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Vlerësimi i ekspertëve Konstatohet se në përputhje me strukturën organizative dhe hierarkinë e UE-së përgjegjësitë për cilësinë janë të shtrira në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat). <i>(Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL). Strukturat në fjalë planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e Sigurimit të Cilësisë. (Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL).</i> Standardet për sigurimin e cilësisë së institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Departamenti i gjuhësisë mban kontakt përmes faqeve në mediat sociale (Facebook dhe Instagram) me të diplomuarit e vet, të cilët vlerësojnë në mënyrë spontane dhe sporadike veprimtari shkencore, por edhe mësimore të departamentit).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Vërejmë se në rregulloren e institucionit dhe atë të Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit BGJSHL.</p> <p>Komisioni i Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe të Programeve të Studimit, një komision i përhershëm institucional i ngritur pranë FSHH-së përbëhet nga katër anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit në UE, është konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me: Harmonizimin e veprimtarisë së të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë; Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë; Hartimin e programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë; Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Vërejmë se programi i studimit BGJSHL nuk iu është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme. Dhe ky raport i hartuar në vitin 2022 po i shërben këtij procesi.</p> <p>Në hartimin e këtij raporti janë përfshirë DGJ dhe DLG që e ofrojnë këtë program studimi dhe janë përgjegjës për këtë program, anëtarë të personelit akademik të këtyre departamenteve dhe ka të përfshirë edhe studentë të këtij programi.</p> <p><i>(shih Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë; Evidenca 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHH për ngritjen e GVB 2022)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vërejmë se në hartimin e këtij raporti janë përfshirë DGJ dhe DLG që e ofrojnë këtë program studimi dhe janë përgjegjës për këtë program, anëtarët e personelit akademik të këtyre departamenteve dhe ka të përfshirë edhe studentë të këtij programi.</p> <p>Aktorët e përfshirë në këtë proces janë persona që gëzojnë një reputacion të pranueshëm akademik dhe procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UNIEL.</p> <p><i>(Shih Evidenca 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në</p>	<p>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe të akreditimit institucional në UE (edhe të këtij programi studimi) nuk janë përfshirë ende ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>


lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.			
Konkluzione	<p><i>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së programit dhe performancës e pedagogëve është një proces tërësisht ligjor dhe që respekton në maksimum integritetin njerëzor dhe akademik të çdo individi dhe shmang maksimalisht çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik e jo akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit në vlerësimin e brendshëm të cilësisë tij. Praktikisht, studentët janë pjesë e qeverisjes së Universitetit të Elbasanit, nëpërmjet prezencës së përfaqësuesve të tyre në Senat, Komisionin e përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë, Këshillin studentor dhe Komisionin e etikës.</i></p> <p><i>Konkretisht, studentët e Dgj dhe DLG nuk ishin plotësisht të përfshirë dhe të njohur me strukturat e cituara më sipër, por ata shprehin opinionet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet angazhimit periodik në anketimet studentore.</i></p> <p><i>Gjatë komunikimeve me dekanen, GVB-në dhe stafin akademik nuk u konfirmua strategji për tërheqjen e bashkëpunëtorëve, apo ekspertëve të jashtëm për mendime të specilizuara në lidhje me cilësinë e programit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Sipas të dhënave bashkangjitur, pohojmë se në UE instrumenti më i përdorur lidhur me vlerësimin e cilësisë së programit të studimit BGJSHL është pyetësi i institucionit me studentët. Ky i fundit organizohet në përfundim të çdo semestri apo në fillim të sezonit të provimeve, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe palëve të interesuara dhe gjithashtu, publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it. Studentët mund të njihen, kështu, me rezultatet e këtij pyetësi.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE))</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Sipas të dhënave të depozituara në dosjen për akreditim, pohojmë se UE publikon të dhënat e realizuara si rezultat i pyetësorëve institucionalë me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Gjatë hartimit të raportit respektohet liria dhe etika akademike, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	<p>Gjithashtu, UE e ka publikuar raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet ueb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p>Por ky program studimi po vlerësohet për herë të parë dhe për këtë nuk ka rezultate të publikuara ende në uebsitin e UE-së.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE))</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Mbështetur në referencat bashkangjitur, vërejmë se UE vlerëson dhe siguron që veprimtaritë akademike, mësimore dhe shkencore të kenë ndikim dhe lidhje me procesin e mësimdhënies akademike dhe të nxisin përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Veprimtaritë e zhvilluara nga DGJ dhe DLG lidhen me përmbajtjen e programit BSHGJL dhe kjo garanton përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor në kuadër të këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE))</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas të dhënave që gjenden në dosje, pohojmë se UE vlerëson dhe siguron që veprimtaritë akademike, mësimore dhe shkencore të kenë ndikim dhe lidhje me procesin e mësimdhënies akademike dhe të nxisin përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Veprimtaritë e zhvilluara nga DGJ dhe DLG lidhen me përmbajtjen e programit BSHGJL dhe kjo garanton përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor në kuadër të këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE))</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në varësi të dokumentacionit dhe vizitës së bërë në UE, vërejmë se ky institucion nuk investon në vijimësi për trajnimin e pedagogëve me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto trajnime duhet të lidhen kryesisht me metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të institucionit në të gjitha nivelet (departament, fakultet, rektorat) dhe me instrumentet matës, me të cilat kryhet vlerësimi i brendshëm.</p> <p>Por departamenti i gjuhësisë ka organizuar trajnime dhe këshillime për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Vetëm në kuadrin e vlerësimit të brendshëm të vitit 2022 studentët kanë marrë pjesë në këtë trajnim dhe në takimin me përfaqësues të ASCAL.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>U konfirmua prezenca e një sërë raportesh nga struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë; raporte të analizës vjetore të njësisë bazë dhe raport i NJSBC për vitin akademik 2020-2021. Në raportet e analizave vjetore janë diskutuar gjetjet e strukturave të sigurimit të cilësisë dhe janë parashikuar masa për përmirësimin e problematikës së vërejtur lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Mbledhjet e departamentit, shërbejnë për njohjen me arritjet, mangësitë, problematikat dhe praktikat lidhur me sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore.</i></p>

	<i>GVJ sugjeron që Institucioni të organizojë më shumë veprimtari me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, të realizojë veprimtari për trajnimin e stafit në kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Staf», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit trashëgon eksperiencën e programit tradicional, ka vazhdimësi në programin e ciklit të dytë dhe ka përputhje të plotë me fushën akademike dhe shkencore të FSHH-së.
2. Staf i akademik zotëron kompetenca të shumëllojshme dhe ka kualifikim të lartë akademik.
3. Struktura përgjegjëse për realizimin e programit bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kurrikulës me nevojat dinamike të tregut të punës.

Pika të dobëta:

1. Universitetet e tjera në zona të afërta gjeografike ofrojnë programe të njëjta/ të ngjashme studimi që mund të ndikojnë në uljen e ndjeshme të numrit të studentëve. *(Standardi V.5, kriteri 5)*
2. Konkurrencë e fortë nga programe të tjera studimi, më të pëlqyeshme midis të rinjve, të ofruara nga vetë Universiteti i Elbasanit. *(Standardi V.4, kriteri II)*
3. Mungesa e përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. *(Standardi III.1, kriteri 6)*

Rekomandime:

1. Rritjen e efektivitetit të laboratorëve didaktikë-shkencorë në përgjithësi dhe funksionalizimin e pajisjeve moderne që egzistojnë në disa prej këtyre laboratorëve në veçanti.
2. Përditësimin e faqes zyrtare të internetit të UE-së në funksion të rritjes së sigurisë së shfrytëzimit të saj dhe përmirësimin e përmbajtjes së informacionit në shërbim të studentëve, sidomos për sa i takon informacionit që ofrohet në gjuhën angleze.
3. Zgjerimin e kontakteve me institucione publike e jo publike, biznese, në funksion të zgjerimit të mundësive për aftësim të vazhdueshëm të studentëve, përditësimin dhe përmirësimin e studimeve për tregun e punës.
4. Bashkëpunim më të thelluar me departamentet simotra në universitete në të gjithë hapësirën shqipfolëse, si dhe me katedrat e albanologjisë jashtë vendit.
5. Të punohet për ndërkombëtarizimin e departamentit, për të integruar dhe shfrytëzuar me dinamizëm kapacitetet akademike, si dhe për kontakte në përputhje me zhvillimin e rajonit dhe me elemente të globale me rikonceptim dhe rivlerësim të vlerave tona kombëtare.
6. Të shtojë përpjekjet për hapjen e programeve të përbashkëta me universitete të huaja, në dobi të prirjeve bashkëkohore që arsimit i lartë ka sot në Republikën e Shqipërisë, për zhvillime të reja dhe konkrete, për mundësi zhvillimi dhe rritjen e ofertës së punësimit për studentëve.
7. Të shikohet mundësia e ngritjes së një Bordi këshillimor me partnerë strategjikë për tregun e punës në nivel fakulteti.

SWOT

Conclusions of the Evaluation of the first cycle of Bachelor's Study program in "Albanian Language and Literature" offered by the Institution of Higher Education "Aleksandër Xhuvani University, Elbasan"

Strengths and Affirmations:


1. The study program inherits the experience of the traditional program, has continuity in the program of the second cycle, and is fully compatible with the academic and scientific field of the FHS.
2. The academic staff possesses diverse competencies and has a high academic qualification.
3. The structure responsible for the implementation of the program makes continuous efforts to improve the curriculum with the dynamic needs of the labor market.

Weak points:

1. Other universities in nearby geographical areas offer the same/similar study programs that may affect the significant decrease in the number of students. *(Standard V.5, criterion 5)*
2. Strong competition from other study programs, more popular among young people, offered by the University of Elbasan. *(Standard V.4, criterion II)*
3. Lack of involvement in national and international projects. *(Standard III.1, criterion 6)*

Recommendations:

1. Increasing the effectiveness of didactic-scientific laboratories in general and the functioning of modern equipment that exists in some of these laboratories in particular.
2. Updating the official EU website in order to increase the security of its utilization and improve the content of the information at the student's service desks, especially with regard to the information provided in English.
3. Expanding contacts with public and non-public institutions, and businesses, in order to expand opportunities for continuous training of students, updating and improving studies for the labor market.
4. Deeper cooperation with sister departments in universities throughout the Albanian-speaking area, as well as with Albanianology departments abroad.
5. To work for the internationalization of the department, to dynamically integrate and utilize academic capacity, as well as for contacts in accordance with the development of the region and with global elements by reconceptualization and reevaluation of our national values.
6. To increase the efforts for the opening of joint programs with foreign universities, to the avail of the contemporary trends that higher education has today in the Republic of Albania, for new and substantial developments, for growth opportunities and expanding the employment offer for students .




7. To consider the possibility of setting up an advisory board with strategic partners for the labor market at the faculty level.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

